



DEPARTAMENTI PËR DEMOKRATIZIM

BASHKANGJITJA

ZËRI I MINORITETEVE



autorë:

Mauro Arrigoni
Anna-Maria Biro
Sehadin Shok
Claire Vallings

përkthyesë:

Dhurata Rexhëbeqaj
Lumni Rama
Figen Kazaz
Biserka Ivanović
Adela Stojiljković

dizajni:

Shpend Kada



Mission in Kosovo

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
Departamenti për Demokratizim

PARATHËNIE

Misioni i OSBE-së në Kosovë është të mbështes zhvillimin e strukturave demokratike të cilat përfaqësojnë interesin e përbashkët të të gjitha bashkësive në Kosovë. Në kuadër të OSBE-së programet për mbështetjen e bashkësive etnike përqëndrohen në çështjet e pajtimit, integritit dhe ngritjes së kapaciteteve, mbështetjes së vlerave demokratike përbrenda bashkësive etnike dhe përmirësimit të pozitës së tyre kundrejt bashkësive tjera etnike dhe qeverisë së përkohshme. Projekti Zëri i Votuesve është pjesë e këtyre përpjekjeve.

Në kohën kur do të publikohet ky punim në Kosovë janë mbajtur Zgjedhjet e dyta Komunale ku morrën pjesë të gjitha komunitetet. Në nivelin lokal për të parandaluar diskriminimin ndëretnik në strukturën e Kuvendit Komunal përfaqësuesit e atyre bashkësive etnike që nuk kanë marrë pjesë në Zgjedhjet e para Komunale para dy vitesh ishin emëruar nga Bashkësia Ndërkombëtare. Në ndërkohë u ndërmorrën edhe masa të tjera. Rregullorja 2000/45 e UNMIK-ut mbi "Vetqeverisjen e Komunave të Kosovës" siguroi themelimin e domosdoshëm të komiteteve të komuniteteve dhe të ndërmjetësimit. Kjo u ka bërë të mundshme individëve ose grupeve të individëve nga bashkësitë etnike, gjuhësore ose religjioze të parashkrojnë ankesa pranë Komunës në rast të diskriminimit nga ana e administratës, ankesë kjo e cila mëtutje i është dërguar Komitetit të Ndërmjetësimit për zgjidhje përfundimtare.

Me themelimin e kornizës institucionale në nivelin lokal mbrojtja e të drejtave të minoriteteve, partitë politike dhe organizatat e shoqërisë civile në Kosovë kanë pasur mbështetje të pandërprerë nga OSBE-ja me qëllim të rritjes së kapaciteteve organizative. Siç vazhdon kjo punë, OSBE-ja shpreson që kjo fletushkë të jetë e dobishme për Kuvendet e reja Komunale dhe vepruesit kyç ndërkombëtarë pas zgjedhjeve të këtij viti si udhëzues në punën e tyre gjatë viteve që vijnë. Më e rëndësishme është ajo që ne dëshirojmë që kjo fletushkë të kontribuoj në kuptimin më të mirë të situatës së përgjithshme të minoriteteve josërbe në Kosovë dhe të mbështes pjesëmarrjen efikase të minoriteteve në qeverisjen lokale, në veçanti.

*Ambasadori Pascal Fieschi
Zëvendës i Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm
Shef i Misionit të OSBE-së në Kosovë*

Përmbajtja

1.	Hyrje	05
2.	Përmbledhja	06
3.	Përmbledhja për regjion	
	Pejë	11
	Prizren	14
	Mitrovicë	17
	Gjilan	21
	Prishtinë	25
4.	Konkluzat dhe rekomandimet	29
5.	Anekset	
	<i>Aneksi I:</i> Lista e takimeve të bëra me minoritetet në tërë Kosovën në korrik 2002	33
	<i>Aneksi II:</i> Pyetsori	35
	<i>Aneksi III:</i> Gjuha zyrtare e minoritetëve dhe përfaqësuesit e minoriteteve jo serbe nëpër komunat ku është bërë hulumtimi.	37
	<i>Aneksi IV:</i> Rekomandimet e Lund-it të OSBE-së mbi pjesë marrjen efektive të minoriteteve kombëtare në jetën publike	39
6.	Për lexim të mëtutjeshëm	45
7.	Harta: Komunitat në Kosovë	46

HYRJE

Si vijimi i projektit Zëri i Votuesve,¹ 'Bashkangjitja - Zëri i Minoriteteve' ka për qëllim të hartoj rekomandime për të gjitha komunat e Kosovës. Rekomandimet i përgjigjen brengave të paraqitura nga popullata minoritare jo-sërbe në Kosovë. Përqëndrimi në minoritetet jo-sërbe² rrjedh nga ideja që vazhdimisht është paraqitur nga bashkësitë më të vogla në Kosovë, që thonë se brengat e tyre gjithmonë kanë qenë të mohuara gjatë procesit të ndërtimit të institucioneve gjatë këtyre tre viteve të fundit.

Ky studim, i realizuar në bashkëpunim me bashkësitë minoritare jo-sërbe në Kosovë është i pari i këtij lloji sipas qëllimit që ka dhe shkallës së përfshirjes. Sidoqoftë, në të gjitha mbledhjet u bë e qartë që është tejet e vështirë të grumbullohen të dhëna të sakta si rreth sigurimit të shërbimeve ashtu edhe rreth kushteve të përgjithshme jetësore të minoriteteve në Kosovë. Për më tepër, ndërtimi i institucioneve për rregullimin e diversitetit etnik ende është në fazë tejet të hershme. Në jetën e minoriteteve ende janë të rrënjosura efektet e konfliktit të vitit 1999. Brengat e tyre përfshijnë sigurinë, mungesën e lëvizjes, të drejtat mbi pronësinë, papunësinë dhe një grumbull çështjesh me të cilat ballafaqohen si personat e zhvendosur përbrenda vendit ashtu edhe refugjatët. Veç kësaj, nuk ka vetëm ndarje apo konkurrencë në mes të bashkësive por gjithashtu ndarje të thella në kuadër të një bashkësie që e bën bashkëpunimin të vështirë.

Ky publikim sado i mangët është një përpjekje që të ndihmoj procesin e gjatë ndërtimit të institucioneve dhe pjesëmarrjen e minoriteteve në Kosovë. Në këto mbledhje, OSBE-ja dhe IFES-i ishin dëshmitarë që ekziston vendosshmëri që të kuptohen perspektiva të ndryshme. Shpresohet që bashkësitë minoritare do të vazhdojnë dialogun që është nisur nën udhëheqjen e 'Bashkangjitja / Zëri i Minoriteteve'.

METODOLOGJIA

Fondacioni Ndërkombëtar për Sistemet Zgjedhore (IFES-i) dhe Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE-ja) i kanë udhëhequr mbi 70 mbledhje në tërë Kosovën me grupet e minoriteteve si Ashkalitë, Boshnjakët, Kroatët, Egjiptasit, Goranët, Romët dhe Turqit.³ Mbi 800 persona morrën pjesë në diskutime dhe u përgjegjën në pyetësorët ose anketën,⁴ që adresuan dy nga fushat kryesore të shërbimeve komunale, (1) shërbimet e lidhura me kushtet e përgjithshme jetësore - **shërbime publike** dhe (2) **shërbimet specifike për minoritetet** lidhur me mbrojtjen dhe promovimin e identitetit etnik dhe gjuhësor të bashkësive të ndryshme. Pyetësi ishte i përkthyer në gjuhët vendase të grupeve relevante. Nga grupet është kërkuar të japin komentet e tyre rreth qasjes në ndërtesat komunale si dhe të tregojnë se sa herë e kanë vizituar atë. Veç kësaj, nga të anketuarit gjithashtu është kërkuar t'i vlerësojnë shtatë shërbimet komunale që në bazë të përvojës të fituar gjatë projektit të Zërit të Votuesve janë konsideruar si më të rëndësishme. Në kuadër të këtyre **shërbimeve publike** përfshihen: zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik; furnizimi me ujë dhe menaxhimi i mbeturinave; rrugët lokale dhe transporti; kujdesi mjekësor dhe mirëqenia sociale.

¹ Shih Zërin e Votuesve: Brengat e Bashkësive (2000) dhe Zërin e Votuesve: Brengat e Kosovës (2001), të dyja hulumtime dhe publikime të misionit të OSBE-së në Kosovë, Departamenti i Demokratizimit.

² Në kuadër të kësaj fletushke termi "minoritet" i emërton "minoritetet josërbe".

³ Shih Shtojcën I për të parë listën e mbledhjeve të mbajtura me bashkësitë e ndryshme minoritare nëpër Kosovë

⁴ Shih Shtojcën II për të parë kopjen e Pyetësorëve

Anketa e shpërndarë i mbulon katër fusha kryesore të shërbimeve publike specifike për minoritetet.

- **Përdorimi i gjuhës së minoriteteve në shërbimet publike duke përfshirë: komunikimin në gjuhën e minoriteteve në Komunë; ekzistimin e dokumenteve zyrtare në gjuhën e minoriteteve; emrat e vendeve në gjuhën e minoriteteve dhe shenjat publike në gjuhën e minoriteteve.**
- **Arsimi në gjuhën e minoriteteve në nivelin parashkollor, fillor dhe të mesëm.**
- **Ngjarjet kulturore të organizuara nga komuna për një minoritet të vetëm ose ngjarje ndërkulturore.**
- **Pjesëmarrja në strukturat komunale nga anëtarë të zgjedhur ose të emëruar të bashkësive minoritare dhe punëtorët e shërbimit civil ose të punësuar të tjerë në Komuna.**

Në fazën e dytë të projektit janë prodhuar një varg fletushkash (një për rajon) në bazë të përgjegjjeve të mbledhura nëpërmes të anketës së lartpërmendur. Këto fletushka rajonale janë përkthyer në të gjitha gjuhët relevante të minoriteteve në formë të përmbledhjes së fakteve. Duhet të theksohet që qëllimi i parë i kësaj ankete ishte prezantimi i perceptimeve, vështrimeve dhe mendimeve të minoriteteve të ndryshme rreth qasjes që kanë ato në shërbimet komunale. Këto fakte janë tejet të rëndësishme ngase ato e shprehin perceptimin e minoriteteve josërbe në Kosovë rreth kushteve të tyre jetësore.

Në fazën e tretë të projektit janë organizuar mbledhje për hir të vazhdimësisë në secilin rajon me ata pjesëtarë të bashkësive minoritare të cilët fillimisht kishin marrë pjesë në anketë. Kësaj here, pjesëmarrësit ishin përfaqësues të bashkësive - udhëheqës të bashkësive, gazetarë, mësues dhe anëtarë të OJQ-ve të ndryshme - me qëllim të kërkimit të kritikave dhe komenteve rreth informatave të mbledhura nga anketa. Nga pjesëmarrësit u kërkua që të hartojnë rekomandime në vepruesit kryesor ose përmirësimin e shërbimeve komunale specifike për minoritetet.

Varianti përfundimtar i kësaj ankete i përmban komentet e paraqitura në mbledhjet rajonale që janë pasqyrim i mospajtimeve të mëdha në mes të nivelit të informimit të të anketuarve lidhur me pyetjet që qëndrojnë në anketë dhe atë të përfaqësuesve të bashkësive. Ndryshimet në mes të perceptimeve janë të cekura qartë në pjesën e narativit.

Kjo fletushkë i paraqet rezultatet e fakteve të mbledhura nëpër rajone dhe i përmban rekomandimet e hartuara për të gjitha rajonet. Së bashku, si faktet ashtu edhe rekomandimet duhet të merren si udhërrëfyes në brengat shoqërore, politike dhe kulturore të banorëve pjesëtarë të minoriteteve josërbe në Kosovën sot. Kjo gjithashtu mund të shërbejë si bazë për të gjetur mënyrat se si të trajtohen këto çështje.

PASQYRA E ANKETËS

Janë dy brenga më madhore që i kontribuojnë ndjenjës së izolimit tek grupet minoritare. E para është papunësia dhe pjesa dërrmuese ndjehen të pafuqishëm që të përmirësojnë situatën e tyre pa ndihmë. Brenga e dytë me rradhë është se punëtorët e komunave ose i mohojnë ose nuk i adresojnë çështjet specifike të minoriteteve. Grupet minoritare nuk mendojnë se janë të përfaqësuara mirë qoftë nga anëtarët e kuvendit komunal ose nga udhëheqësit e bashkësive. Disa prej tyre thonë se përfaqësuesit e tyre kanë ndikim të vogël gjë që e shton ndjenjën e kufizimit. Të gjitha bashkësitë pa marrë parasysh nëse ndjehen mirë të përfaqësuar ose jo kërkuan kontakt më të mirë me përfaqësuesit e vet dhe punëtorët e komunës. Në tabelën mëposhtë mund të gjeni një përmbledhje të shkurtër të brengave kryesore të bashkësive të ndryshme minoritare dhe përshkrimin e perceptimit që ata ia bëjnë marrëdhënieve që ekzistojnë në mes tyre dhe përfaqësuesve të vet në përgjithësi.

Bashkësia	Brengat kryesore	Marrëdhëniet me përfaqësuesit
Ashkalitë	Papunësia; arsimi; të zhgënjyer me strukturat komunale	I besojnë përfaqësuesve
Boshnjakët	Papunësia; arsimi dhe kultura; liria e lëvizjes dhe çështjet e sigurisë personale në Mitrovicë/veri të Mitrovicës	Të kënaqur mirëpo në përgjithësi pajtohen se nuk janë aktiv sa duhet
Kroatët	Siguria personale (transporti); kultura	Mungesa e besimit
Egjiptianët	Arsimi; papunësia	Të dobëta
Goranët	Papunësia; gjuha; respekti për bashkësinë; komunikimi (në Dragash). Frika nga shtypja.	Të dobëta
Romët	Papunësia; situata ekonomike; gjuha (dhe përdorimi i saj në arsim); mungesa e kontaktit me qeverinë lokale	Të pakënaqur (përpos në Pejë)
Turqit	Të zhgënjyer me qeverinë lokale	Të kënaqur

Grupet minoritare janë të mbyllur në një qark brenda së cilit ndjehen të përgjatur nga proceset vendimmarrëse. Ndjenja e paaftësisë që të ushtrojnë ndikim në ngjarjet politike ose ekonomike përbëhet nga trashëgimia post-komuniste e administratës klientale publike. Të gjitha të lartpërmendurat përbëhen nga mungesa e karakterit të shërbimit publik në nivelin komunal. Veç kësaj, disa pjesëtarë të minoritetit Boshnjak kanë treguar ngurrim nga personat e tyre publik që të angazhohen në sferën politike e cila pjesërisht mund t'i ketë rrënjët e saj në trashëgiminë komuniste të mungesës së madhe të besimit drejt çdo gjëje që është e lidhur me politikë.

Është e qartë që ata që i kanë kushtet më të këqija të jetës ndihen më së paku të aftë t'i shprehin brengat e tyre nëpër komunat përkatëse, qoftë nga frika ose ndëshkimi, mungesa e besimit, përfaqësimi i dobët, distanca gjeografike nga ndërtesat komunale apo edhe në të vërtetë kombinimi i këtyre faktorëve. Këto bashkësi fillojnë të kërkojnë ndihmë jashtë qeverive të veta lokale në veçanti nga bashkësitë ndërkombëtare. Sa më pak të fuqishme dhe të mobilizuara politikisht të jenë grupet aq më i fortë është perceptimi që organizatat ndërkombëtare kanë pushtet më të madh në krijimin e të ardhmes. Kjo e dobëson edhe më tutje autoritetin që i është dhënë komunave për t'i adresuar brengat e popullatës së tyre lokale. Në planin afatgjatë kjo mund të shkaktoj fyrije të dyanshme në mes të qeverisë lokale dhe bashkësive minoritare.

Përfundimisht, është e dukshme që për minoritetet papunësia është çështje më me rëndësi se sigurimi i mirëqenies sociale. Është e qartë se mirëqenia sociale nuk shihet si zgjedhje e qëndrueshme për të ardhmen andaj edhe punësimi dhe pavarësia janë prioritete më të larta.

Fushat tjera specifike të çështjeve preokupuese të theksuara nga bashkësitë minoritare josërbe mund t'i gjeni mëposhtë.

Qasja në ndërtesat komunale⁵

Në përgjithësi, 78% të anketuarve thonë se ndërtesat komunale janë të hapura ndaj të gjithëve. Mungesa e transportit shpeshherë e kombinuar me çështjet e sigurisë janë arsytet më madhore sepse disa bashkësi mendojnë se ndërtesat komunale janë të paarritshme. Edhe përkundër kësaj përqindje të lartë, 35% të të gjithë pjesëmarrësve e pranojnë

faktin që nuk e kanë vizituar komunën e tyre gjatë vitit të kaluar. Përderisa kjo e paraqet më pak se gjysmën e tërë pjesëmarrësve të projektit shifrat tregojnë mungesë të besimit në strukturat që ekzistojnë dhe ndjenjën e zhgënjimit dhe pakënaqësisë që çështjet nuk janë adresuar në të kaluarën (e me siguri as në të ardhmen).

Shërbimet publike

Të gjithë pjesëmarrësit i vlerësojnë shërbimet publike si të "dobëta" dhe "shumë të dobëta". Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik dhe sigurimi i mirëqenies sociale në mënyrë konstante vlerësohen si shërbimet më të varfëra nga të gjitha bashkësitë. Të njëjtat bashkësi në rajone të ndryshme kishin vështrime të ndryshme rreth shërbimeve publike. Për shembull, Boshnjakët në Mitrovicë i vlerësojnë shërbimet e veta publike shumë më pak të favorshme se sa ata në Prizren. Ndryshimet në mes të rajoneve janë të habitshme. Shërbimet publike në rajonin e Gjilanit konsiderohen të jenë të mira në përgjithësi mirëpo bashkësitë minoritare në komunën e Vitisë i vlerësojnë shërbimet e veta më dobët se kudo tjetër në Kosovë. Ky është vetëm një nga shembujt që dëshmon se në të njëjtin rajon komuna më e madhe ofron shërbime të kualitetit më të lartë se cilado komunë tjetër më e vogël: sa më e vogël të jetë bashkësitë dhe komuna, më i madh është niveli i kritikës rreth sigurimit të shërbimeve publike.

Standardet e kujdesit mjekësor dhe transportit publik megjithatë në përgjithësi shihen më pozitivisht se shërbimet tjera. Kujdesi mjekësor, në veçanti është brengë madhore për shumë bashkësi dhe aty ku ai vlerësohet pozitivisht është ngase komunat kanë bërë nisje pozitive në adresimin e këtij prioriteti publik. Sidoqoftë, në çdo mbledhje rajonale pjesëtarët e bashkësisë Rome ankohen në diskriminim sistematik kundër individëve Romë nëpër objektet e kujdesit mjekësor. Është e qartë që në përgjithësi të gjitha grupet i shohin shërbimet publike si të një standardi tejte të ulët. Në përgjithësi asnjëri nga shërbimet nuk është vlerësuar si "mesatar" (apo më lartë) nga grupet.

Në tabelën mëposhtë mund t'i gjeni vlerësimet mbarëkosovare të bashkësive më të mëdha minoritare të disa shërbimeve komunale të përfshira në Pyetësor:

Shërbimi Minoriteti	Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik	Furnizimi me ujë	Menaxhimi i mbeturinave	Rrugët lokale	Transporti lokal	Kujdesi mjekësor	Mirëqenia sociale
Ashkalitë	2.09	2.23	2.21	2.09	2.62	2.78	2.01
Boshnjakët	2.07	2.57	2.27	2.53	2.69	2.41	1.91
Kroatët	1.1	1	1	1	1	2.2	1.3
Egjiptasit	1.92	1.55	1.58	2.71	2.78	2.67	2.51
Goranët	1.48	1.68	1.45	1.43	2	1.7	1.53
Romët	1.71	2.05	2.08	2.07	2.06	2.49	1.73
Turqit	1.38	1.8	1.85	1.76	1.69	2.25	1.5

* 1 : shumë dobët 2 : dobët 3 : mesatar 4 : mirë 5 : shumë mirë

⁵ Në Pyetësor ky term përdoret për të përshkruar qasjen fizike.

Në të gjitha mbledhjet e mbajtura në nivelin rajonal përfaqësuesit e minoriteteve kryesore në përgjithësi u pajtuan me notat e dhëna në tabelën më lartë. Mirëpo është theksuar se është tejet e vështirë të përgjithësohen të gjitha këto ngase siç mund të vihen re ndryshime të mëdha nëpër rajone ashtu mund të vërehen ndryshime edhe në kuadër të grupeve minoritare. Këto dallime janë edhe më të dukshme kur janë në pyetje shërbimet specifike për minoritetet, përfshirë këtu sigurimin e informacioneve dhe shërbimeve në gjuhën amtare të tërë personave në nivelin komunal. Informacionet më të hollësishme rreth këtyre çështjeve mund të gjeni në seksionet rajonale të kësaj fletushke.





Komunikimi

Ekziston një ndarje e fortë në mes të grupeve në pyetjen nëse mund të komunikojnë me personelin e komunës në gjuhën e tyre amtare dhe nëse dokumentet publike zyrtare ekzistojnë në gjuhën e tyre amtare. Në përgjithësi këto janë të mundshme për **Ashkalitë**, **Boshnjakët** dhe **Egjiptasit** dhe diku vetëm pak më tepër se gjysma e **Goranëve** dhe më pak se çereku i **Kroatëve**, **Romëve**⁶ dhe **Turqit** pajto-

hen. Të gjitha grupet pajtohen se shenjat publike në gjuhën e tyre amtare janë edhe më të rralla.

Në grafikonet e mëposhtme mund të gjeni një pasqyrë të përgjithshme për Kosovën rreth katër aspekteve të komunikimit në gjuhë amtare në nivelin e qeverisë lokale. Është vërejtur se disa nga këto grafikone janë kritikuar ashpër nga disa pjesëtarë të grupeve të ndryshme minoritare, në veçanti nga Boshnjakët dhe Ashkalitë. Gjithashtu është vërejtur se situata e Boshnjakëve në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë as që mund të krahasohet me atë të atyre që jetojnë në rajonin e Prizrenit për shkak të rrethanave të ndryshme që mbizotërojnë në këto pjesë.

Duhet të theksohet që këto grafikone kanë shërbyer si pikënisje për debate, pikat kryesore të së cilave janë përmblodhur në seksionin rajonal të kësaj fletushke. Këto ndryshime nëpër rajone gjithashtu nënkuptojnë që pasqyra e përgjithësuar e Kosovës mund të çojnë drejtim të gabuar. Për shembull, disa përfaqësues të bashkësisë së Ashkalive thonë se situata e tyre në Ferizaj dhe Vushtrri kanë ndryshime të dukshme në lidhje me sigurinë, lirinë e lëvizjes dhe qasjen në shërbimet publike.



Arsimi


Të gjitha bashkësitë kanë dhënë komente rreth mundësive shtesë për arsimim në gjuhën e tyre amtare në të gjitha nivelet. Sërish **Ashkalitë**, **Boshnjakët**, **Egjiptasit** dhe **Turqit** thonë se ky arsim është i mundshëm në nivelin fillor dhe të mesëm mirëpo që një gjë e tillë nuk vlen edhe për nivelin parashkollor. Vetëm pak më

tepër se gjysma e **Kroatëve** thonë se arsimi në gjuhën amtare është i mundshëm si në nivelin parashkollor ashtu edhe në atë fillor mirëpo jo edhe në nivelin e mesëm. Ngjashëm, më pak se gjysma e **Goranëve** mendojnë që arsimi fillor dhe i mesëm në gjuhën e tyre amtare është i mundshëm dhe më pak se çereku kanë qasje në nivelin

⁶ Pjesa më e madhe e bashkësisë Rome në Kosovë flasin sërbiisht dhe shqip përderisa numri i Romëve që e flasin gjuhën rome është duke rënë. Për shembull nga 356 të anketuarë Romë vetëm 75 (21%) kërkuan Pyetësor në gjuhën rome gjë që tregon se përdorimi i gjuhës është tejet i ulët. Megjithatë përgjigjet e dhëna në përdorimin e gjuhës amtare i referohen gjuhës rome si gjuhë të parë. Të dhënat faktike rreth përdorimit të gjuhës rome në komunikim dhe arsim janë në përgjithësi më të ulëta se ato që vërehen në përgjegje.

parashkollor. Grupet **Rome** thonë se kanë qasje më të vogël në arsim në gjuhë amtare se cilado bashkësi tjetër ku më pak se çereku i tyre thonë se arsimi në gjuhën e tyre amtare është i mundshëm në çdo nivel⁷. Është interesante të vërehet se ato grupe që kanë qasje në nivel

më të lartë të arsimit në gjuhë amtare bëjnë thirrje më të forta në arsim në gjuhë amtare në nivelin e universitetit, në veçanti Boshnjakët e veriut të Mitrovicës dhe bashkësisë Turke në tërë Kosovën.




Kultura

Ngjarjet kulturore të organizuara nga komuna mund të jenë ose specifike për një bashkësi ose ndërkulturore. Sidoqoftë vetëm pak më tepër se gjysma e pjesëmarrësve e grupeve të **Ashkalive** dhe **Egjiptasve** thonë se komunat e tyre kishin organizuar ngjarje kulturore për ta. Ka dallime të mëdha në mes të bashkësive të minoriteteve tjera. Diku një e treta e pjesëmarrësve **Boshnjakë** dhe **Romë** thonë se ngjarjet kulturore ishin të organizuara nga komunat e veta. Mirëpo më pak se një e pesta e bashkësisë **Turke** u pajtuan me të njëjtën gjë. Vetëm tre përqind të **Goranëve** deklaruan se komunat e tyre kishin organizuar aktivitete kulturore përderisa

asgjë nuk ishte organizuar për **Kroatët**. Të gjitha grupet komentuan rreth asaj që komunat e tyre të organizojnë më shumë ngjarje kulturore si të veçanta ashtu edhe të karakterit të përzier.

Në grafikonet mëposhtë nuk mund t'i gjeni të dhënat faktike ngase pjesa më e madhe e minoriteteve dinë pak për organizatorët e ngjarjeve kulturore. Shumë prej përfaqësuesve të minoriteteve, me përjashtime të vogla, thonë se komunat nuk kishin organizuar fare ngjarje kulturore për bashkësitë minoritare. Ato ngjarje që ishin organizuar ishin financuar kryesisht nga organizatat qeveritare dhe joqeveritare ndërkombëtare.



⁷ Në fakt me përjashtim të arsimit jozyrtar parashkollor dhe fillor në gjuhën rome në qytetin e Gjilanit nuk ekziston arsim në gjuhën rome askund tjetër në Kosovë. Andaj përqindjet e paraqitura në grafikone i referohen arsimit në gjuhën shqipe dhe serbe përkritazi me rajonin ku Romët jetojnë.

Pjesëmarrja në strukturat komunale⁸

Është e vështirë të nxjerren përfundime rreth pjesëmarrjes në strukturat komunale si pasojë e ndryshimeve në vështrimet e shprehura nga të anketuarit si në kuadër të një rajoni ashtu edhe përgjatë rajoneve tjera.

Të gjitha grupet minoritare në përgjithësi e dinë nëse ata kanë përfaqësues të tyre në kuvendet përkatëse komunale mirëpo shpesh vjen deri te hutimi kur shtrohet pyetja nëse ata përfaqësues janë të zgjedhur apo të emëruar.⁹ Për shembull disa bashkësi minoritare e njohin faktin që nuk kanë përfaqësues të tyre në kuvend komunal mirëpo megjithatë vazhdojnë t'i përgjigjen pyetjeve të kësaj ankete nëse përfaqësuesit janë të zgjedhur apo të emëruar gjë që tregon se u mungon dituri rreth pjesëmarrjes komunale në përgjithësi. Kjo gjithashtu vë në pah mungesën e vetdijes dhe përvojës rreth ndryshimeve politike në mes të sistemeve të zgjedhjes dhe emërimit të përfaqësimit.

Në pyetjen nëse pjesëmarrësit mendojnë se brengat e tyre adresohen nga përfaqësuesit komunal në përgjithësi, në ato kuvende komunale ku një përfaqësues ishte emëruar për t'i përfaqësuar disa minoritete (p.sh. një Boshnjak për t'i përfaqësuar Boshnjakët dhe Goranët në Mitrovicë), ato bashkësi që nuk ishin të përfaqësuar në formë specifike ndjeheshin që brengat e tyre nuk adresohen. Vetëm **Kroatët** thonë se nuk kanë asnjë pjesëtar të bashkësisë së vet që gëzon pozitë relevante në komunë. Sidoqoftë, **Turqit** dhe **Egjiptasit** gjithashtu nuk përgjigjen pozitivisht në këtë pyetje. Kjo edhe e

sqaron arsyen se pse shumë njerëz nuk i vizitojnë komunat e veta: nëse asnjë pjesëtar i bashkësive minoritare nuk është i punësuar në qeverinë përkatëse lokale komunike në gjuhë amtare shpeshherë do të jetë i pamundshëm. Andaj grupet ndodh të mos kenë besim që t'i vizitojnë komunat e veta për t'i paraqitur brengat e tyre. Në mbledhjet rajonale bëhet e qartë që mospërputhjet në mes të bashkësive të rëndomta dhe përfaqësuesve të vet janë të mëdha dhe perceptimet e situatës mund të ndryshojnë dukshëm. Shkalla e dallimeve ndryshon në kuadër të një minoriteti dhe minoriteteve në mes vete, gjithashtu varet nga niveli i vetorganizimit si dhe profesionalizmi i përfaqësuesve të ndryshëm. Megjithatë është e qartë që ndjenja e izolimit tek bashkësitë minoritare arsyetohet dhe se komunat duke përfshirë përfaqësuesit e minoriteteve do të duhet të nxjerrin përfundime për t'u siguruar që qeveria lokale të zhvillohet në mënyrë që t'i përgjigjet nevojave të tyre. Deri më tash, sa i përket qeverisë lokale në pyetje janë transparenca më e madhe dhe ligjshmëria demokratike.

Seksionet e mëposhtme lidhen me faktet e mbledhura në nivelin rajonal. Çështja e **pjesëmarrjes**¹⁰ nga pjesëtarët e bashkësive minoritare në strukturat komunale nuk është paraqitur me anë të grafikoneve ngase mungojnë informata të sakta dhe për shkak se të anketuarit shprehin pasiguri në përgjegjësitë e veta. Kjo është një fushë ku ka nevojë për aftësim në veçanti dhe ku përvoja nga vet bashkësitë mund të ketë ndikim domethënës në mbrojtjen dhe mbështetjen e të drejtave të minoriteteve.

⁸ Për të dhënat rreth përfaqësuesve të zgjedhur/emëruar të minoriteteve josërbe nëpër komunat e anketuara shih Shtojcën III.

⁹ Nga 1011 anëtarë të kuvendeve komunale të Kosovës 41 deputetë të zgjedhur dhe të emëruar i përkasin minoriteteve josërbe. Kjo e përbën 4% e totalit. Numri i deputetëve josërb të zgjedhur është 13 gjegjësisht 1.28% i totalit dhe numri i atyre të emëruar është 28, pra 2.76% i totalit. (Burimi: Profilët Komunale OSBE, faqja elektronike: www.OSCE.org/kosovo/documents/reports/municipal_profiles)

¹⁰ Shih leximet e mëtejshme për të gjetur më tepër informacione rreth pjesëmarrjes së minoriteteve në qeveri lokale.

Në regjionin e Pejës janë vizituar këto komunitete:

- **Egjiptianët** në komunën e Deçanit, Istogut dhe atë të Gjakovës;
- **Boshnjakët** në komunën e Pejës;
- **Romët** në komunën e Pejës.

Nëntëdhjetë e nëntë përqind të pjesëmarrësve në projekt ndiejnë se kanë një çasje të lehtë në ndërtesën e komunës. Kjo paraqetë përqindjen më të lartë të përgjegjëjeve pozitive në tërë Ksoven. Megjithatë, shumica prej tyre thonë se kurrë nuk e kanë vizituar atë. Kjo posaqërisht vlenë për komunitetin egjiptian. Në komunën e Pejës, shumica e pjesëmarrësve romë dhe boshnjakë kanë thënë se kanë vizituar komunën më shumë se tri here. Nga komentet e tyre shihet çartë se të gjitha grupet minoritare kërkojnë marrëdhënie më të mira dhe kontakte me përfaqësuesit e zgjedhur dhe me zyrtarët e komunës. Komunitetet në komunat më të

vogla kanë pasur më pak besim në vizitimin e qeverive të tyre lokale.

Shërbimet komunale janë vlerësuar më lart në komunën e Pejës se sa në komunat e tjera të regjionit. Përjashtim bëjnë këtu rrugët lokale dhe mirëqenja sociale në komunën e Deçanit që kanë marrë një vlerësim mesatarë. Sidoqoftë, komuniteti romë nuk ka dhënë përgjegjëje pozitive për shërbimet komunale në regjion me një përjashtim të vockël për përkujdesin mjekësorë dhe për transportin publik. Tabela e mëposhtme përmbledhë vlerësimet e disa shërbimeve komunale nga shumica e komuniteteve minoritare të këtij regjioni.

Shërbimi Minoriteti	Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik	Furnizimi me ujë	Menaxhimi i mbeturinave	Rrugët lokale	Transporti lokal	Kujdesi mjekësor	Mirëqenia sociale
Boshnjakët	2.75	2.85	2.4	1.95	3.45	3.6	2.1
Egjiptasit	1.62	1.49	1.67	2.36	2.31	2.21	2.09
Romët	2.2	3.7	1.7	2.3	3.9	4	2.5

1 : shumë dobët 2 : dobët 3 : mesatar 4 : mirë 5 : shumë mirë

Deçan

Për **egjiptianët**¹¹ e Deçanit edukimi paraqetë një çështje të rëndësishme dhe për këtë është bërë kërkesa e ndërtimit të një shkolle në Hereq. Ata theksojnë se shkalla fillore dhe shkalla e mesme e edukimit ekziston por mungon shkalla parashkollore. Furnizimi me ujë është vlerësuar si shumë i dobët dhe mbete njëra nga prioritetet më të mëdha të këtij komuniteti. Në

përgjithësi, egjiptianët kanë një çasje kolektive ndaj zgjedhjes së problemeve dhe pajtohen se shoqëria duhet të jetë më e organizuar për të zhvilluar marrëdhënie me përfaqësuesit e sajë. Ata gjithëashtu e pranojnë se anëtarësimi në komitetin për komunitete u ka mundësuar atyre që interesat e tyre të i paraqiten qeverisë lokale.

Istog

Egjiptianët në Istog kanë marrëdhënie të mira me përfaqësuesit e komunitetit dhe ndiejn se brengat e tyre merren parasysh. Komunikimi në gjuhën amtare dhe edukimi janë në nivel të kënaqshëm dhe nuk paraqesin prioritet për komunitetin. Shërbimet janë vlerësuar si shumë të dobëta por për këtë çështje ka pasur edhe diskutime. Prandaj, egjiptianët janë më të brengosur

për zhvillimin ekonomik dhe për numrin e lartë të papunësuarëve. Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik ka marrë vlerat më të ulëta dhe për këtë komunitet paraqetë njëren nga prioritetet më të rëndësishme. Ky komunitet është mjaft i politizuar dhe shumë i vetëdijshëm se marrëdhëniet e mira me përfaqësuesit e tyre janë të rëndësishme për mirëqenjen në të ardhmen.

¹¹ Gjuha e egjiptianëve të Kosovës është gjuha shqipe.

Gjakovë

Egjiptianët në Gjakovë konsiderojnë se shërbimet e përgjithëshme janë shumë të dobëta, posaqërisht zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik. Ata shprehen për nevojën e marrëdhënies më të mira me përfaqësuesit e tyre pasi që ndiejn se është detyrë e komunës të ofroj shërbime më të mira. Largimi i mbeturinave, kanalizimi dhe ndihma

sociale janë prioritete të larta të këtij komuniteti. Ata theksojnë se prezenca e tyre në kuvendin komunal dhe në komitetin për komunitete do të thotë se intereset e komuniteti të tyre barten në nivelin e komunës. Grupi e shpreh edhe këtë se; shumë pak apo fare nuk ka pasur aktivitete kulturore të organizuara për ta.

Pejë

Të gjithë nga komuna e Pejës që kanë marrë pjesë në këtë projekt ndiejn se kanë pasur një çasje të lehtë në ndërtesën e komunës dhe se shumica prej tyre kanë thënë se e kanë vizituar atë më shumë se tri herë gjatë vitit të kaluar. Përkujdesi shëndetsorë dhe furnizimi me ujë shihen si mesatare, përderisa të tjerat vlerësohen si të dobëta e posaqërisht rrugët lokale.

Romët¹² thonë se komunikimi në komunë është i mundur por theksojnë se dokumentet zyrtare dhe shenjat/emrat e vendëve publike në gjuhen rome mungojnë. Të intervistuarit deklarojnë se edukimi në gjuhen amtare nuk ekzistonë në asnjë shkallë por thonë se për ta janë organizuar aktivitete kulturore nga komuna. Për ta prioritete paraqet zhvillimi ekonomik dhe largimi i mbeturinave. Si shtesë kësaj, ky grup nuk ndien se është mirë i përfaqësuar edhe përkundër faktit se kanë


përfaqësues në kuvendin komunal dhe në komitetin për komunitete.

Boshnjakët deklarojnë se edukimi për fëmijet e tyre është në përgjithësi i mirë ndërsa përkujdesi shëndetsorë është mesatarë. Shenjat publike në gjuhen e tyre amtare ose nuk ekziston ose janë të dëmtuara por kjo nuk paraqetë ndonjë prioritet për këtë komunitet. Në vend të kësaj, ata theksojnë situatën e vështirë rrethë papunësisë dhe nevojën për lidhje më të mira telefonike. Sa i përketë aktiviteteve kulturore të organizuara nga komuna, boshnjakët e Zllopekës thonë se janë organizuar ndërsa ata të Vitomiricës thonë se nuk ka pasur aktivitete të organizuara nga komuna. Sidoqoft, të dy grupet thonë se dëshirojnë që të ketë më tepër aktivitete kulturore. Në përgjithësi ata ndiejn se përfaqësuesit e tyre i paraqesin interesat e tyre, por nuk i kanë kompetencat për të zgjedhur brengat e tyre.

Vështrimet rreth shërbimeve specifike për minoritetet në regjionin e Pejës


Një vështrim i përgjithëshëm për shërbimet publike dhe shërbimet specifike të minoriteteve, në këtë regjion jepet në grafikonet e mëposhtme. Këto grafikone janë nxjerrur nga të dhënat e marra si përgjegjëje të anëtarëve të komuniteteve të minoriteteve në këtë regjion ku janë përfshirë egjiptianët, boshnjakët dhe romët. Diagramët e mëposhtëm tregojnë (1) shkallën e përdorimit të gjuhëve të minoriteteve publikisht, (2) mundësinë e edukimit në gjuhen amtare dhe (3) numrin e ngjarjeve kulturore ashtu siq e kanë parë dhe theksuar komunitetet e minoriteteve për të cilat bëhet fjalë (në grafikonet e mëposhtme paraqiten, në përqindje, përgjegjet në pyetjet e caktuara).

Përdorimi publik i gjuhëve të minoriteteve nëpër komunitete




¹² Romët në Pejë i flasin të dy gjuhët, atë shqipe dhe atë serbe e më pak gjuhen e tyre amtare, atë rome.

Edukimi në gjuhën e tyre amtare nëpër komunitete



Ngjarjet kulturore nëpër komunitete



Në takimin regional të organizuar në fazën e tretë të këtij projekti, pjesëmarrësit nga grupet etnike komentuan vlerësimet e paraqitura grafikonet e më lart shënuar të shërbimeve të përgjithshme në lidhje me kushtet jetësore dhe të shërbimeve specifike për minoritetet. Çështja e pjesëmarrjes së anëtarëve të minoritetëve në strukturat komunale nuk është përfshirë në diagrame për shkak të informatave të pasakta dhe për shkak të pasigurisë së përgjegjëjeve të atyre me të cilët është bërë intervista. U moren këto komente dhe këto vëzhgime të individëve:

- Shkalla e vlerësimit të përkujdesit shëndetsorë është parë si joreale dhe duhet të jetë më e vogël, pasi që kemi të bëjmë me një diskriminim sistematik nga ana e dhënsëve të shërbimeve të përkujdesit shëndetsorë (një romë nga Peja).
- Përdorimi i gjuhës amtare në ndërtesën e komunës mvaret nga personi në person (një boshnjak nga Peja).
- Vlerat në grafikonin për komunikimin në gjuhën amtare i referohen më tepër komunikimit në gjuhë shqipe se sa në atë romë (një romë nga Peja).
- Vlera e paraqitur për çasje në dokumentet zyrtare në gjuhën amtare është shumë më e vogël sesa ajo e paraqitur në grafikon dhe mvaret nga lloji i dokumentit që lëshohet e jo në praktiken e përgjithshme të cilën komuna duhet të e zbatojë kur lëshon dokumente zyrtare në gjuhët e ndryshme (një boshnjak nga Peja).
- Vlerat e paraqitura për edukimin në gjuhën amtare janë reale (një egjiptian nga Peja).
- Edukimi parashkollorë në gjuhën amtare është 50% më i ulët se sa ai i paraqitur në grafikonin për edukim, ndërkaj edukimi fillorë dhe ai i mesëm duhet të vlerësohen deri në 90% (një boshnjak nga Peja).
- Analfabetizmi në mesin e romëve në Pejë është shumë i lart dhe duhet të merret një aksion nga komuna për të e prekur këtë çështje pasi që edukimi parashkollorë, fillor dhe ai i mesëm janë kompetenca të komunës (një romë nga Peja).
- Të gjitha aktivitetet kulturore dhe ndërkulturore janë organizuar vetë nga komunitetet dhe jo nga komuna. Në shumicën e rasteve këto ngjarje marrin përkrahje financiare nga OJQ-të dhe organizatat ndërkombëtare (të gjithë pjesëmarrësit).

Prizreni

Në Prizren janë mbajtur takime me:

- **Bosnjakët** në komunën e Prizrenit
- **Goranët** në komunën e Dragashit
- **Romët** në komunën e Prizrenit
- **Turqit** në komunën e Prizrenit

Të gjitha komunitetet pajtohen, me përjashtim të disa grupeve të turqëve, se kanë çasje në ndërtesat e komunës dhe se numri më i madhë i njerëzve që i vizitojnë ndërtesat e komunës në tërë Kosovën është ai në komunën e Prizrenit. Sidoqoft, shërbimet publike në përgjithësi janë vlerësuar si "të dobëta" posaqërisht në komunën e Dragashit edhe pse ato janë më të favorshme se sa në të gjitha regjionet tjera përveq komunës së Gjilanit.

Komunitetet e vogla (komuniteti turk dhe ai i goranëve) i shohin këto shërbime si pak pozitive. Gjithëashtu ekziston ndjenja e përgjithëshme e diskriminimit dhe izolimit nga komuniteti shumicë në këtë regjion. Tabela e mëposhtme përmbledhë vlerësimet për disa nga shërbimet komunale nga shumica e komuniteteve të minoriteteve në regjionin e Prizrenit:

Shërbimi Minoriteti	Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik	Furnizimi me ujë	Menaxhimi i mbeturinave	Rrugët lokale	Transporti lokal	Kujdesi mjekësor	Mirëqenia sociale
Bosnjakët	2.18	3.23	2.65	3.40	3.33	2.67	2.24
Goranët	1.47	1.70	1.43	1.27	1.70	1.77	1.57
Romët	1.55	3.07	3.29	2.42	2.39	2.42	2.37
Turqit	1.45	1.97	1.9	1.87	1.72	2.4	1.45

1 : shumë dobët 2 : dobët 3 : mesatar 4 : mirë 5 : shumë mirë

Dragash

Goranët në Dragash konsiderojnë se rrugët lokale dhe shërbimet publike kanë nevojë për një vëmendje më të madhe. Ata theksojnë se kanë përfaqësim të mirë në komunën e tyre, në kuvendin komunal dhe në komitetin për komunitete, gjithëashtu edhe në personelin komunal por ata ndjejnë se liderët e tyre nuk kanë qenë në gjendje të shprehin brengat e tyre si duhet. Kjo është parë në përgjegjëjet e tyre për aktivitetet e komunës. Ata munden të komunikojnë në gjuhën e tyre me personelin e qeverisë dhe se kanë çasje në edukimin në gjuhën amtare në të gjitha nivelet, mirpo dokumentet zyrtare dhe shenjat publike kryesisht ende nuk ka në gjuhën e tyre dhe pothuaj asnjë aktivitet kulturorë nuk është organizuar për ta nga komuna. Edhe pse ata janë të bindur se

munden të shprehin brengat e tyre, ata janë ende të pakënaqur me përparimin e bërë deri më tash dhe kërkojnë që të përmirësohen kontaktet me përfaqësuesit e tyre. Për momentin ata ende i drejtohen bashkësisë ndërkombëtare për të ndërmarrë ndonjë veprim për ta, në vend që të mbështeten në strukturat e tyre komunale. Të drejtat e pronës ende paraqesin brenga për ata sikurse edhe liria e të lëvizurit dhe komunikimi në përgjithësi (shembulli që e përmenden ata është mungesa e stacioneve televizive dhe radio stacioneve në gjuhën e tyre). Standardet e edukimit dhe aktivitetet kulturore janë përshkruar si "katastrofike" dhe disa anëtarë thanë se janë të diskriminuar nga popullata shumicë.

Prizren

Të tri komunitetet e vizituara në Prizren (bosnjakët, turqit dhe romët) shprehin frikën e tyre për diskriminimin e bërë nga popullata shumicë. Çfardo lloj izolimi shton

frikën për identitetin e komuniteteve. Edhe pse të gjitha komunitetet u pajtuan se kurrfarë aktivitetesh kulturore nuk janë organizuar për ta nga komunat prej nga vinë, as

ata vetë nuk kishin bërë një gjë të tillë. Por sidoçoft, të gjithë mbesin optimist sa i përket të ardhmes. Shërbimi publik i cili kishte prioritetin më të lart ishte zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik.

Boshnjakët theksuan si prioritet dhe brengë të komunitetit të tyre mungesën e ndihmes sociale. Me përfundim të boshnjakëve në Lubinjen e Eperme, ata ndiejn se janë mirë të përfaqësuar në komunë dhe i pranojnë përfaqësuesit e tyre në kuvendin komunal dhe në komitetin për komunitetet dhe se ata kanë qenë në gjendje të i paraqesin brengat e komunitetit të tyre. Komunikimi me personelin e komunës është i mundur në gjuhen e tyre amtare, dokumentet zyrtare ekzistojnë poashtu në gjuhen e tyre amtare. Me këtë të fundit posaqërisht nuk u pajtuan një grup i boshnjakëve nga Lubinja e Eperme. Të gjitha grupet theksuan se shenjat publike nuk janë në gjuhen e tyre amtare. U theksua se edukimi në gjuhen amtare ekziston në shkallen parashkollore, atë fillore dhe atë të mesme. Sidoçoft, shumica janë të papunësuar, kështu që papunësia paraqet brengjen kryesore së bashku me dëshirën për punësimin e pjesëtarëve të këtij komiteti në qeverinë lokale. Ekziston dëshira e përgjithëshme për transparencë më të madhe dhe për bashkpunim me popullatën shumicë. Si shtesë, boshnjakët theksuan lëshimin e dokumenteve të udhëtimit për fëmijë si një çështje me rëndësi.

Romët deklaruan se kërkojnë kontakte më të afërta me përfaqësuesit e tyre, që mund të shihet si një përmirësim i përgjithëshëm në situatën e tyre. Rindërtimi i shtëpive paraqet një brengë të madhe sikurse edhe edukimi në


gjuhen amtare. Ata shprehen se komunikimi në gjuhen e tyre amtare nuk është i mundur me personelin e komunës dhe se dokumentet zyrtare nuk janë në gjuhen e tyre¹³. Ata janë të përfaqësuar në kuvendin komunal dhe në komitetin për komunitete dhe ndiejn se disa nga brengat e tyre u janë paraqitur organeve. Ekziston në përgjithësi frika se përfaqësuesit e komunitetit veprojnë më tepër individualisht se sa në të mirë të tërë grupit. Për këtë arsye romët iu besojnë më shumë ndërkombëtarëve. Duhet të përmirësohet ky status kuo sepse ata dëshirojnë lidhje më të mira liderët e tyre.

Komuniteti turk në Prizren ka kërkuar disa zgjidhje praktike për të përmirësuar standardin e tyre të jetës. Përderisa shumica e pjesëmarrësëve ishin të punësuar, papunësi ende paraqet një brengë të madhe për ta, posaqërisht për të rinjtë. Dëshira për shmangjen e diskriminimit në praktiken e punësimit u shpreh, që tregon se ata ndiejn se kjo ka ndodhur në të kaluarën. Përveq këtyre edhe furnizimi me ujë, një qendër rinore, përkujdesi i përgjithëshëm shëndetsorë, ndërtimi i rrugëve, mbledhja e mbeturinave dhe edukimi në gjuhen amtare në universitet u theksuan si brenga të mëdha. Ata shprehen pakënaqësin e tyre me përfaqësuesit e tyre në komunë dhe për strukturat komunale në përgjithësi dhe shprehen dëshirën që në të ardhmen brengat e tyre të përcillen më tepër. Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik për ata paraqet shërbimin publik që kërkon vëmendjen e plotë. Ata theksuan se komunikimi në gjuhen amtare në komunë është i vështirë dhe se dokumentet zyrtare në gjuhen turke mungojnë.

Vështrimet rreth shërbimeve specifike për minoritetet në regjionin e Prizrenit


Një vështrim i përgjithëshëm për shërbimet publike dhe shërbimet specifike të minoriteteve, në këtë regjion jepet në grafikonet e mëposhtme. Këto grafikone janë nxjerrur nga të dhënat e marra si përgjegjëje të anëtarëve të komuniteteve të minoriteteve në këtë regjion ku janë përfshirë egjiptianët boshnjakët dhe romët. Diagramët e mëposhtëm tregojnë (1) shkallën e përdorimit të gjuhëve të minoriteteve publikisht, (2) mundësinë e edukimit në gjuhen amtare dhe (3) numrin e ngjarjeve kulturore ashtu siq e kanë parë dhe theksuar komunitetet e minoriteteve për të cilat bëhet fjalë (në grafikonet e mëposhtme paraqiten, në përqindje, përgjegjet në pyetjet e caktuara).

Përdorimi publik i gjuhëve të minoriteteve nëpër komunitete




¹³ Në këtë rast fjala është për gjuhen rome pasiqë romët në Prizren i flasin edhe gjuhen shqipe edhe atë serbe si shtesë gjuhës rome.

Edukimi në gjuhën e tyre amtare nëpër komunitete



Ngjarjet kulturore nëpër komunitete



Në takimin regjional të organizuar në fazën e tretë të këtij projekti, pjesëmarrësit nga grupet etnike komentuan vlerësimet e paraqitura grafikonet e më lart shënuar të shërbimeve të përgjithshme në lidhje me kushtet jetësore dhe të shërbimeve specifike për minoritetet. Çështja e pjesëmarrjes së anëtarëve të minoriteteve në strukturat komunale nuk është përfshirë në diagrame për shkak të informatave të pasakta dhe për shkak të pasigurisë së përgjegjëjeve të atyre me të cilët është bërë intervista. U moren këto komente dhe këto vëzhgime të individëve:

- Në qendrat për mbarrëvajtje sociale nuk është i punësuar as edhe një person nga grupet etnike në tërë regjionin. Kjo çështje duhet të rishikohet dhe të përmirësohet (të gjithë pjesëmarrësit).
- Shifrat për vlerësim të ndihmë sociale janë shumë të larta (një boshnjak dhe një romë nga Prizreni)
- Vlerat për edukimin parashkollor duhet të përgjysmohen ndërkaj për edukimin fillorë dhe të mesëm janë të sakta (një goran nga Dragashi).
- Të gjitha vlerat e paraqitura në grafikone janë të sakta (një turk nga Prizreni)
- Ngjarjet kulturore janë të organizuara nga vetë komunitetet (të gjithë pjesëmarrësit).

Meetings in Mitrovicë/Mitrovica region were held with:

- **Ashkalitë** në Mitrovicë dhe Vushtrri
- **Boshnjakët** në Mitrovicë dhe Leposaviq
- **Goranët** në Mitrovicë
- **Romët** në Mitrovicë, Leposaviq dhe Zveçan
- **Turqit** në Mitrovicë dhe Vushtrri.

Në përgjithësi, niveli i pakënaqësisë për kushtet e jetes së përditëshme është dukshëm më i lartë në këtë regjion se sa kudo tjetër në Kosovë. Pothuaj se të gjitha grupet e vizituara shprehen rëndësinë e përfaqësuesve të zgjedhur, duke dhënë një bindje se ekziston një vetëdijësim më i lart politikë në mesin e grupeve të minoriteteve se sa në regjionet e tjera të Kosovës. Identiteti i komunitetit (dhe humbja e këtij identiteti) ishte një nga temat e zakonshme në mesin e këtyre gupeve të këtij regjioni. Grupet ndiheshin të lëna pasdore nga qeveria lokale dhe ishin te brengosur se do të humbin identitetin e tyre dallues si rezultat i kësaj. Kjo është e shprehur shumë më shumë se sa në regjionet tjera.

Shumica e pjesëmarrësve pajtohen se kanë çasje në ndërtesën e komunës, por shihet qartë se njerzit nga komuna më e madhe, pra komuna e Mitrovicës, e kanë vizituar komunën me shpesh se sa në komunat e tjera për rrethë. Prap se prap, shumica e popullatës nuk e ka vizituar fare komunën.

Shërbimet publike në përgjithësi janë të vlerësuara si shumë të dobëta në këtë regjion dhe rangohet si më të dobëtat në tërë Kosovën. Kjo është posaqërisht e vërtet për komunën e Leposaviqit sa i përket shërbimeve të komuniteteve. Tabela e mëposhtme tregon vlerësimet e dhëna për shërbimet e ndryshme publike nga shumica e komuniteteve të minoriteteve në këtë regjion.

Shërbimi Minoriteti	Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik	Furnizimi me ujë	Menaxhimi i mbeturinave	Rrugët lokale	Transporti lokal	Kujdesi mjekësor	Mirëqenia sociale
Ashkali	1.42	1.40	1.32	1.90	2.20	2.27	1.42
Boshnjakë	1.65	1.75	1.77	1.82	1.93	1.67	1.42
Romë	1.15	1.39	1.36	1.88	1.81	1.91	1.32
Turq	1.18	1.56	1.65	1.57	1.63	1.86	1.5

1 : shumë dobët 2 : dobët 3 : mesatar 4 : mirë 5 : shumë mirë

Secili grup, me përjashtim të disa ashkalinjëve, deklaruan se edukimi në gjuhen amtare për momentin nuk ekziston dhe kanë përmendur arsye të ndryshme për këtë. Ekziston një numër shumë i vogël i pjestarëve të komuniteteve të minoriteteve që punojnë si personel o komunës posaqërisht në Leposaviq dhe Zveçan. Dokumentet zyrtare dhe shenjat publike në gjuhen amtare nuk

ekzistojnë dhe shumica e pjesëtarëve daklorojnë se nuk janë organizuar aktivitete kulturore për ta. Komunitetet ndihen se nuk janë të përfaqësuara mirë intereset e tyre, përveq tek komunitetet e komunës së Vushtrrisë, ku ekziston një lavdërim për lideret e komunitetit të minoriteteve edhe pse nuk kanë asnjë përfaqësues as në kuvendin komunal e as në komitetin për komunitete.

Leposaviq

Në përgjithësi, romët dhe boshnjakët e Leposaviqit ndihen se janë të lënë anash pothuaj se krejt nga qeveria lokale edhe pse të dy komunitetet pranojnë rëndësinë e bashkpunimit me komunën. Sipas rangimit të çasjes në shërbimet publike situata në Leposaviq është më e keqja në tërë Kosovën.

Grupet romëve¹⁴ në Leposaviq thonës se kanë çasje të lehtë në ndërtesën e komunës edhe pse shumë pak prej tyre e kanë vizituar atë në vitin e kaluar. Ata thonë

se do të e vizitonin komunën vetëm atëherë kur kanë ndonjë nevojë të madhe për të. Papunësia është njëra ndër brengat më të mëdha të tyre por edhe statusi i tyre shoqërorë dhe rrespektimi për ta si grup paraqet njëren ndër prioritetet për ata. Tregojnë se disa aktivitete kulturore janë organizuar për ata por dëshirojnë më tepër. Pasi që nuk kanë asnjë përfaqësues as në kuvendin komunal e as në komitetin për komunitete ata ndihen të pafuqishëm për të bërë diçka vetë por ata thanë se

¹⁴ Romët e regjionit të Mitrovicës përveç gjuhës rome flasin edhe gjuhen serbe.

shkruarja e letër ankesave kryetarit të kuvendit komunës dhe administratorit ndërkombëtarë të komunës do të u ndihmonte atyre në paraqitjen e interesave të tyre. Kjo tregon se ata janë të vetëdijshëm se cilat struktura dhe cilët individ mund të u përmirësojnë përfaqësimin e tyre në komunë. Romët flasin edhe për përkujdesin shëndetsor si njëren nga prioritetet tyre dhe për dëshirën që fëmijve të tyre të u jepet më shumë konsideratë. Këtë gjë e dëshmon edhe fakti se në komunën e Leposaviqit nuk ka edukim në gjuhën e tyre amtare. Si shtesë kësaj, komunikimi në gjuhën rome në komunë nuk është i mundëshëm posaqërisht pasi që nuk ka asnjë romë të punësuar në komunë. Dokumentet zyrtare dhe shenjat publike nuk ekzistojnë në gjuhën rome.

Mitrovicë

Të gjitha komunitetet e këaj komune thonë se ndërtesa e komunës për ta është e hapur dhe në përgjithësi është mjaft mirë e vizituar nga të gjitha komunitetet. Sidoçoft, më pak se gjysma e pjesëmarrësëve turq shprehen rezerva për çasjen e plotë në komunë. Në përgjithësi shërbimet janë të vlerësuara si "shumë të dobëta" dhe vërehet se shërbimet në jug janë pak më të mira se sa në veri të komunës. Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik dhe mirëqenja sociale paraqiten si prioritetet kryesore në përgjithësi. Në përgjithësi komunitetet e minoriteteve mendojnë se nuk janë mirë të përfaqësuara në komunën e tyre. Shumica e pjesëmarrësëve u përgjegjen negativisht në pyetjet sa i përket komunikimit dhe edukimit në gjuhën amtare dhe në oragnizimin e aktiviteteve kulturore.

Boshnjakët në veri të qytetit ndiejn se ndërtesa e komunës për ta nuk është e hapur përderisa ata në jug mendojnë pozitivisht për këtë çështje. Siguria për ata që jetojnë në veri paraqetë një çështje serioze posaqërisht në lidhje me edukimin. Si komunitet, edukimi për ta në shkallët e ulëta ka më pak prioritet se sa edukimi në univerzitet. Përsëri ka thirrje nga ky komunitet për më tepër rrespekt si minoritet. Boshnjakët nga lagjja e boshnjakëve ndiejn se ata paraqesin një urë në mesë të dy grupeve të mëdha etnike në regjion por në anën negative; ata ndihen se janë zënë pisk në mesë të dy grupeve. Grupi shpreh frikën se situata e përgjithëshme e tyre, përfshirë këtu çështjen e sigurisë dhe edukimin në gjuhën amtare do të thotë se do të i shtyjë ata të e lënë këtë vend. Nga frika e humbjes së identitetit të tyre ata shprehin interes të madhë në organizimin e ngjarjeve kulturore për ta nga komuna. Ata e kuptojnë se qeveria lokale ka përgjegjësinë për të ndërmarrë aksion për përmirësimin e kushteve të tyre të jetes por të dëshpëruar në të ata i drejtohen vetëm bashkësisë ndërkombëtare për zgjedhjen e problemeve të tyre. Komuniteti dëshiron të ketë lidhje më të afërta me liderët edhepse e ndiejn se ata kanë pasur shumë pak mundësi të shprehin brengat e komunitetit në mënyrë adekuate.

Goranët në Mitrovicë kryesisht brengosen për mungesën e rrespektit që tregohet ndaj tyre dhe thonë se frigohen të shkojnë në ndërtesën e komunës dhe të paraqesin brengat e tyre. Përgjegjëjet e tyre janë negative sa i përket komunikimit, edukimi, ngjarjeve kulturore si dhe për përfaqësimin e tyre në kuvendin komunal dhe në komitetin për komunitete. Ata shprehin njëfarë ndjenje të

Boshnjakët theksojnë se ata nuk ballfaqohen me barrierën e gjuhës kur kanë të bëjnë me komunën. Edhe edukimi në gjuhën amtare për fëmijet e tyre ekziston në shkallën para shkollorë dhe atë të mesme por për ata nuk janë organizuar kurrfarë aktiviteteve kulturore qofshin ato vetem për ta apo të përziera me komunitetet e tjera. Edhepse e kanë nga një përfaqësues si në kuvendin komunal si në komitetin për komunitete ata mendojnë se kjo për ta nuk ka pasur ndonjë efekt pozitiv. Sidoçoft, ata e pranojnë rëndësinë e përfaqësuesit të zgjedhur dhe se ai mundet të i paraqet interesat e tyre në jetën e komunës. Kishte edhe interesim për të formuar ndonjë parti politike apo iniciativë qytetare dhe u kërkua që të kenë më tepër takime publike në mënyrë që brengat dhe kërkesat e tyre mund të diskutoheshin hapur.

të qenit të izoluar dhe të injoruar si dhe frikën e humbjes së identitetit të tyre. Kësaj i shkon në favor edhe mungesa e edukimit në gjuhën amtare dhe mungesa e shpresës për ndryshime.

Sikurse edhe në komunat e tjera edhe **romët** në komunën e Mitrovicës janë kryesisht të papunësuar dhe për këtë kjo për ta paraqetë brengën kryesore. Edhe për këtë çështje edhe për çështjet e tjera romët nuk kanë besim në qeverinë lokale. Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik si dhe ndihmat sociale paraqesin prioritetet kryesore të komunitetit. Ka pasur edhe kërkesa se komuna duhet të punësoj anëtarë të komunitet romë që informojnë më mirë komunitetin për aktiviteteve e komunës. Romët nuk ndiejn se janë të përfaqësuar mirë në komunë dhe deklarojnë se nuk janë organizuar fare aktivitete kulturore për ta. Ata kërkojnë që edukimi në gjuhën amtare të u mundësohet edhe fëmijëve të tyre.

Edhe **ashkalitë** janë shumica të papunësuar dhe përsëri e theksojnë këtë si çështjen e tyre primare. Ata i besojnë liderëve të tyre dhe konsiderojnë se kanë marrëdhënie të mira me popullatën shumicë në komunë. Shumica prej tyre e kanë vizituar komunën më shpesh se tri herë gjatë vitit të kaluar. Kjo do të thotë se marrëdhëniet janë të mirë dhe se ata kanë besim më tepër për të vizituar komunën dhe të shtrojnë brengat e tyre për të u zgjedhur aty. Komuniteti shprehet pozitivisht sa i përket komunikimit në komunë, për edukimin dhe për organizimin e aktiviteteve kulturore por nuk ndihen se janë mirë të përfaqësuar. Ata mendojnë se qeveria lokale në masë të madhe i injoron ata. Ata janë të dëshpëruar nga mungesa e veprimit gjatë viteve të kaluara. Si rezultat i kësaj, ky komunitet shehë si dobiprurëse në të ardhmen vetëm donacionet nga jashtë. Si shërbim publikë me më prioritet për ta është rregullimi i furnizimit me ujë.

Edhe **turqit** deklarojnë se papunësia është brenga e tyre kryesore. Përdorimi i gjuhës turke publikisht paraqetë tjetren brengë me prioritet për ta. Ata nuk ndiejnë se janë mirë të përfaqësuar por sidoçoftë ata mendojnë se përfaqësuesit e tyre janë duke bërë një punë të mirë sa përket përfaqësimit të brengave të tyre. Dëshpërimi në mungesën e veprimit të komunës në tërësi i ka shtyrë ata që më tepër të mbeshtesin besimin e tyre në qeverinë qendrore dhe në PSSP-në për të ndërmarrë ndonjë veprim.

Vushtrri

Edhe **turqit** edhe **ashaklinjët** në Vushtrri shprehin besimin e tyre në liderët e komunitetit të tyre dhe ndiejn se ata i përfaqësojnë brengat e tyre mirë. Sidoçoft, të dyja grupet ndiejn se qeveria lokale i injoron ata dhe ata i kanë vlerësuar shërbimet publike si shumë të dobëta. Ata nuk kanë përfaqësuesit e tyre në kuvendin komunal.

Ashakalinjët nuk mendojnë se ndërtesa e kuvendit është e hapur për ta dhe se shumica prej tyre nuk e kanë vizituar atë gjatë vitit të kaluar por ata tregojnë se munden të shprehen në gjuhën e tyre amtare në komunë dhe se dokumente zyrtare dhe shenja publike ka për ta. Ata shprehen edhe për dëshpërimin për premtimet e papërbushura të qeverisë lokale dhe ndiejn se nëse nuk përfshihen atëherë ata ndiejn se nuk janë në gjendje që

vetë të ndërmarrin ndonjë veprim. Mirëqenja sociale për ta paraqetë njërin ndër prioritete.

Turqit shprehin një dëshpërim të njëjtë dhe konsiderojnë se as UNMIK-u e as qeveria lokale nuk i rrespekton ata. Ata theksojnë se komunikimi në komunë (edhe në dokumentet zyrtare) dhe edukimi në gjuhën amtare duhet të u mundësohet dhe se më tepër aktivitete kulturore duhet të organizohen për ta. Ata kanë një përfaqësues në komitetin për komunitete dhe thonë se kjo u ka ndihmuar shumë që të i shprehin brengat e komunitetit të tyre. Posaqërisht, ata ende kanë probleme me leternjoftime për shkak të pasaktësisë së të dhënave dhe keqshqiptimit të emrave të tyre

Zveçan


Edhe në Zveçan **romët** konsiderojnë se komuna është hapur për ta por kryesisht nuk e vizitojnë. Ky grup dyshon pothuaj në secilin, përfshirë këtu edhe qeverinë lokale dhe nuk kanë ndonjë lider të vërtet të cilit do të ia falnin besimin. Zhvillimi qëndrueshëm ekonomik dhe furnizimi me ujë janë brengat prioritare për ta. Edhe për ta, papunësia e madhe është edhe një brengë tjetër e madhe. Disa shprehen dëshiren për të punuar në komunë dhe kishte edhe thirrje që të kenë përfaqësues e zgjedhur, që tregon se si komunitet ata ndihen të

lënë anash. Ata e kuptojnë se vetem në bashkpunim me qeverinë lokale munden të përmirësojnë standardin e tyre jetësor. Përdorimi i gjuhës dhe edukimi paraqesin prioritete për ta. Ata japin përgjegjëje negative sa i përket komunikimit në gjuhën e tyre amtare në komunë, për dokumentet zyrtare në gjuhën e tyre si dhe për përdorimin e gjuhës romë në të gjitha shkallët e edukimit. Theksojnë edhe atë se aktivitete kulturore për ta nuk janë organizuar dhe kërkojnë që një gjë e tillë të bëhet.


Vështrimet rreth shërbimeve specifike për minoritetet në regjionin e Prizrenit

Një vështrim i përgjithshëm për shërbimet publike dhe shërbimet specifike të minoriteteve, në këtë regjion jepet në grafikonet e mëposhtme. Këto grafikone janë nxjerrur nga të dhënat e marra si përgjegjëje të anëtarëve të komuniteteve të minoriteteve në këtë regjion ku janë përfshirë ashakalinjët boshnjakët/goranët, romët dhe turqit. Diagramët e mëposhtëm tregojnë (1) shkallën e përdorimit të gjuhëve të minoriteteve publikisht, (2) mundësinë e edukimit në gjuhën amtare dhe (3) numrin e ngjarjeve kulturore ashtu siq e kanë parë dhe theksuar komunitetet e minoriteteve për të cilat bëhet fjalë (në grafikonet e mëposhtme paraqiten, në përqindje, përgjegjet në pyetjet e caktuara).


Përdorimi publik i gjuhëve të minoriteteve nëpër komunitete



Edukimi në gjuhën e tyre amtare nëpër komunitete



Ngjarjet kulturore nëpër komunitete



Në takimin regjional të organizuar në fazën e tretë të këtij projekti, pjesëmarrësit nga grupet etnike komentuan vlerësimet e paraqitura grafikonet e më lart shënuar të shërbimeve të përgjithshme në lidhje me kushtet jetësore dhe të shërbimeve specifike për minoritetet. U moren këto komente dhe këto vëzhgime të individëve:

- Pjesëmarrësit u pajtuan se me rezultatet që i kishin, të i vendosin shërbimet komunale të regjionit në vendin e fundit në Kosovë.
- Vlera shumë të larta ishin dhënë përdorimit të gjuhës amtare. Realiteti, siç u tha, do të ishte vlera e përgjysmuar e vlerave të prezentuara (një boshnjak/goran nga Mitrovica)
- Vlerat e paraqitura në grafikonin e edukimit ishin korrekte. Duhet të shënohet se romët e intervistuar kanë vlerësuar edukimin në gjuhën e tyre amtare si zero, gjë që tregon vetëdijësimin për identitetin (një romë nga Mitrovica dhe Leposaviqi).

Në regjionin e Gjilanit janë mbajtur takime me:

- **Ashkalitë** në Ferizaj;
- **Kroatët** në Viti
- **Romët**¹⁵ në Ferizaj, Gjilan, Novo Bërd dhe Viti
- **Turqit** në Gjilan.

Me përjashtim të turqëve, të gjitha komunitetet tjera ndihen të lëna pas dore nga komunat e tyre. Siguria gjithëashtu paraqet një çështje serioze posaqërisht kur ka të bëjë me përdorimin e gjuhës së komunitetit publikisht. Së bashku, këto pika japin një ndjenjë të izolimit të komuniteteve më të fort se diku tjetër në Kosovë. Si shtesë kësaj, të gjitha komunitetet përqendrohen plotësisht për ndihmë në bashkësinë ndërkombëtare e jo në përfaqësuesit e tyre të zgjedhur apo në personelin e komunës. Brengat për siguri shihen edhe në faktin se disa thirrje për të ndërmarrë veprim i janë bërë KFOR-it dhe

UNMIK-ut, diçka që nuk ka ndodhur në regjionet tjera. Në përgjithësi, kjo tregon se izolimit i është bashkuar mungesa e besimit në qeverinë lokale dhe për këtë kërkohen mënyra tjera (zakonisht përmesë agjensioneve ndërkombëtare) për përmirësimin e kushteve të jetes së përditëshme.

Në përgjithësi të gjithë kanë çasje në komunë. Edhe pse shërbimet konsiderohen në përgjithësi si "të dobëta", për një margjinë të vogël janë më të larta se kudo tjetër në Kosovë. Tabela e mëposhtme tregon vlerësimet e shumices së minoriteteve të regjionit të Gjilanit.

Shërbimi Minoriteti	Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik	Furnizimi me ujë	Menaxhimi i mbeturinave	Rrugët lokale	Transporti lokal	Kujdesi mjekësor	Mirëqenia sociale
Ashkalitë	2.36	2.88	2.80	2.43	3.15	2.80	2.20
Kroatët	1	1	1	2	1.5	2.5	1
Romët	2.02	2.18	2.49	2.04	2.70	2.57	1.83
Turqit	1.48	1.56	2.04	1.68	1.64	2.44	1.68

1 : shumë dobët 2 : dobët 3 : mesatar 4 : mirë 5 : shumë mirë

Ferizaj

Të dy grupet, ai i romëve dhe ai i ashkalinjëve në Ferizaj pajtohen se kanë çasjen në ndërtesën e komunës. Shërbimet janë pak nën mesatare që paraqet vlerën më të lartë në të gjitha komunat e këtij regjioni. Rrugët lokale janë paraqitur si prioriteti më i lartë, derisa zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik dhe mirëqenia sociale paraqesin brengat më të mëdha të të dyja komuniteteve.

Ashkalinjtë ndiejn se kanë marrëdhënie të mira me përfaqësuesit e tyre dhe theksojnë se interesat e tyre janë përfaqësuar nga kuvendi komunal dhe nga komiteti për komunitete. Ata theksojnë nevojën për mbajtjen dhe përmirësimin e këtyre lidhjeve të mira. Kushtet e edukimit i vlerësojnë si të dobëta dhe kritikojnë pamundësin për të u shkolluar në univerzitet. Pasi që gjuha shqipe është gjuha amtare e ashkalinjëve, pra, edukimi nuk paraqet ndonjë problem. Njëkohësisht, çështja e komunikimit në

gjuhen e tyre amtare në komunë dhe prania e dokumenteve zyrtare si dhe prania e shenjave publike në gjuhen e tyre amtare nuk paraqesin ndonjë problem për ata. Problemet që i brengosin ata më shumti janë mungesa e mundësive për punësim dhe ndjenja se komuna ekskluzivisht është e përqendruar në minoritetin serb. Brenga tjera janë edhe largimi i dobët i mbeturinave dhe efekti që kjo ka në ambientin, mungesat e ambienteve sportive si dhe rrymat e elektrike. Përkujdesi mjekësor mbetet prioritet i komunitetit edhe pse është vlerësuar më shumë se mesatarë. Ashkalinjtë pranojnë se janë organizuar ngjarje kulturore nga komuna por ata dëshirojnë që të ketë më tepër.

Komuniteti romë i Ferizajit tha se komunikimi në gjuhen rome në komunë është i pamundur. Edhe dokumentet zyrtare edhe shenjat publike nuk ekzistojnë në gjuhen rome.

¹⁵ Për të i kuptuar më mirë çështjet specifike për gjuhë, duhet të theksohet se përveç gjuhës rome, romët në Ferizaj flasin edhe shqipen edhe serbishten dhe shumica prej tyre në Gjilan, Novo Bërd dhe Viti e flasin serbishten.

Përdorimi i gjuhës së tyre publikisht ishte brenga kryesore e këtij komuniteti dhe tema që u diskutua më së shumti në takimet që i kemi pasur me ta. Kjo reflektohet negativisht edhe në edukimin e tyre në gjuhën amtare por çështja e edukimit nuk ka qenë tema e diskutimeve. Theks i posaqëm është vënë përdorimine gjuhës rome publikisht. Romët të cilët nuk mundën të komunikojnë në asnjë gjuhë tjetër përveç gjuhës rome, kanë frikë të përdorin transportin publik dhe kjo forcon më tepër izolimin e tyre. Grupet rome japin një vlerë më të ulët shërbimeve publike se sa ashkalitë në këtë komunë. Nevoja për ndihmë sociale është e madhe sepse ndihmat sociale janë të vogla dhe kjo qonë deri te mvarësia më e madhe se tek komunitetet tjera për ndihmë nga jashtë. Kjo mvar-

tësi vetem do shtohet nëse ata nuk e ndiejn vehten të lirë të lëvizin dhe të ndryshojn situaten vetë. Bazuar në këtë, ata nuk kanë shpresa të mëdha, nuk shohin mundësi për të ndërmarrë aksion vetë dhe vazhdojnë të presin ndihmë nga jashtë. Por sidoqoft, vetëbesimi për të u shprehur në takime ishte më i madhë se sa tek komunitetet tjera. Ata kanë marrëdhënie të mira me përfaqësuesit e tyre në kuvendin komunal dhe në komitetin për komunitete dhe ndiejn se interesat e tyre janë të përfaqësuar si duhet. Prapseprap ata për ndihmë i drejtohen bashkësisë ndërkombëtare. Grupet rome thonë se aktivitete kulturore janë organizuar por kërkojnë më tepër dhe mendojnë se ashkalitë janë trajtuar më mirë në këtë drejtim.

Gjilan

Romët në komunën e Gjilanit (si dhe komuniteti turk) ndiejn se kanë më pak çasje në komunë se sa që kanë ata të komunës së Ferizajit. Kjo vie për shkak të frikës dhe mungesës së transportit. Si pasoj e kësaj, shumica e këtyre dy komuniteteve nuk kanë vizituar komunën asnjë herë vitin e kaluar. Të dy komunitetet i vlerësojnë shërbimet publike më dobët se sa ato të Ferizajit. Si njëra ndër nevojat me prioritet shihet zhvillimi ekonomik. Të dy komunitetet theksojnë vështirësitë për komunikim në gjuhën amtare në komunë dhe se mungojnë dokumentet zyrtare dhe shenjat publike në gjuhët amtare të këtyre komuniteteve.

Romët posaqërisht ndihen si të diskriminuar dhe besojnë se "gjuha rome duhet të jetë gjuhë zyrtare". Njëkohësisht, mungesa e edukimit në gjuhën amtare nuk paraqet ndonjë çështje serioze. Ata theksojnë se edukimi parashkollorë dhe ai fillor është i mundshëm në lagjen e romëve në Gjilan. Edukimi i mesëm është e qart se nuk ekziston fare. Papunësia dhe si rezultat i kësaj standardi i ulët i jetës mbeten prioritetet dhe brenga kryesore. Edhe kthimi i romëve të shpërngulur është prioritet. Kjo gjë vetem sa vërteton friken se komunitetet minoritare në regjionin e Gjilanit po e humbin identitetin e tyre si grupe. Në përgjithësi mendojnë se komuna nuk ka organizuar aktivitete kulturore për ta dhe se kjo gjë u ka mbetur atyre dhe shprehen se janë të dëshpëruar edhe

në UNMIK-un edhe me komunën. Prapseprap ata i drejtohen UNMIK-ut për të rregulluar këtë gjë dhe se nuk kanë besim në kapacitetin e qeverisë lokale. Ata e ndiejn se nuk janë fare të përfaqësuar as në kuvendin komunal e as në komitetin për komunitete dhe theksojnë (gjë që është e më se e vërtetë) se askush nga ata nuk punon në asnjë pozitë në komunë.

Turqit në Gjilan kanë marrëdhënie të mira me përfaqësuesit e tyre dhe mendojnë se janë të përfaqësuar mjaftë mirë në kuvendin komunal. Ata theksojnë se pjesëmarrja e tyre në komitetin për komunitete nuk ka dhënë ndonjë rezultat konkret. Brenga kryesore e tyre është si të përmirësohen marrëdhëniet me kuvendin komunal dhe si të dërgohen projektet më lehtë në komunë. Gjithëashtu ata dëshirojnë një zyrë për degen lokale të partisë së tyre. Ata theksojnë se edukimi në gjuhën amtare nuk ekziston në shkallën e mesme, është shumë i rëndësishëm dhe fuqishëm kërkojnë që edukimi në gjuhën turke të mundësohet edhe në universitet. Edukimi i mesëm është vlerësuar përgjithësisht si i dobët. Ata thonë se nuk mund të flasin gjuhën e tyre në komunë dhe kjo mundet të jetë arsyeja pse shumica e tyre nuk e kanë vizituar komunën fare. Mungesa e shenjave publike në gjuhën turke ka qenë njëra nga temat qendrore të diskutimit. Ndërtimi i një qendre shëndetsore në Dobruçan është diskutuar gjatë.

Novobërdë

Romët në Novo Bërd përgjithësisht mendojnë se kanë çasje në ndërtesën e komunës dhe shumica prej atyre që ishin prezent në takim kishin vizituar atë më shumë se tri herë gjatë vitit të kaluar. Sidoqoftë, të gjitha shërbimet publike janë vlerësuar si "shumë të dobëta", dhe paraqesin njëren nga vlerat më të ulëta në tërë Kosovën. Të gjithë pjesëmarrësit ishin të papunësuar dhe natyrisht që theksuan papunësinë si brengën e tyre kryesore. Ata dëshirojnë marrëdhënie më të mira me përfaqësuesit e tyre por ndiejn se përfaqësuesi i emruar nuk ka qenë në gjendje të i paraqetë brengat e tyre mbrenda komunës. Shumica e tyre jetojnë prej ndihmes humanitare, shumica prej tyre janë analfabet dhe i kanë

të gjitha shpresat në ndihmen nga jashtë. Ata ndiejn se komuna nuk dëgjon se çka ata thonë dhe shprehen dëshirën për një informim më të mirë për takimet që mbahen në regjion. Kanë të drejtë kur theksojnë se askush prej rradhëve të tyre nuk asnjë pozitë në personelin e komunës. Edukimi në gjuhën amtare nuk ekziston për komunitetin e tyre, komunikimi me personelin e komunes është i vështirë dhe nuk ekzistojnë shenja publike në gjuhën rome. Asnjë aktivitet kulturorë nuk është organizuar për ta nga komuna.

Edhe romët edhe kroatët në Viti ndiejn se kanë çasje në ndërtesën komunës edhe pse askush prej tyre nuk e ka vizituar atë gjatë vitit të kaluar. Të gjitha shërbimet janë vlerësuar si "shumë të dobëta". Të dy komunitetet ndihen të izoluar dhe ndiejn se nuk mundën të bëjnë asgjë vetë për të e përmirësuar situatën e tyre. Ata ndiejn edhe se KFOR-i dhe UNMIK-u janë përgjegjës të iu ndihmojnë në ndryshimin e situatës së tyre. Të dy grupet theksojnë ndihmën e dobët sociale dhe brengat për sigurinë, ndërkaq komuniteti kroat deklaron se "nuk ka mbetur asnjë kroat pa u rrahur apo pa u maltretuar së paku një herë gjatë vitit të kaluar".

Kroatët theksojnë si prioritetë edhe transportin, përkujdesin shëndetsorë dhe çështjet e pronës. Ata


kërkojnë që "shtëpitë e uzurpuara" të kthehen dhe të mbrohen edhe kërkojnë të kenë liri më të madhe të lëvizjes. Pra, shihet qart se çështja e sigurisë për këtë grup ende nuk është zgjedhur. Ndjenja e tyre se ende kërcënohen shihet në faktin se ata kërkojnë mbrojtjen e monumenteve kulturore të cilat ende shkatërrohen.

Grupi i **romëve** ndihet se është mirë i përfaqësuar. Është e vërtetë se ata nuk kanë asnjë përfaqësues as në kuvendin komunal e as në komitetin për komunitete dhe asnjë punëtorë në personelin e komunës. Papunësia dhe ndihmat e vogla sociale janë brengat kryesore të tyre.


Vështrimet rreth shërbimeve specifike për minoritetet në regjionin e Prizrenit

Një vështrim i përgjithshëm për shërbimet publike dhe shërbimet specifike të minoriteteve, në këtë regjion jepet në grafikonet e mëposhtme. Këto grafikone janë nxjerrur nga të dhënat e marra si përgjegjëje të anëtarëve të komuniteteve të minoriteteve në këtë regjion ku janë përfshirë ashkallitë, kroatët, romët dhe turqit. Diagramët e mëposhtëm tregojnë (1) shkallën e përdorimit të gjuhëve të minoriteteve publikisht, (2) mundësinë e edukimit në gjuhën amtare dhe (3) numrin e ngjarjeve kulturore ashtu siq e kanë parë dhe theksuar komunitetet e minoriteteve për të cilat bëhet fjalë (në grafikonet e mëposhtme paraqiten, në përqindje, përgjegjet në pyetjet e caktuara).


Përdorimi publik i gjuhëve të minoriteteve nëpër komunitete



Edukimi në gjuhën e tyre amtare nëpër komunitete



Ngjarjet kulturore nëpër komunitete



Në regjionin e Prishtinës janë bërë takime me:

- **Grupet e romëve** nga Lipjani, Obiliçi dhe Prishtina;
- Me komunitetin **kroat** në Lipjan;
- Me grupet e përziera **rome dhe ashkali** në Fushë Kosovë, Obiliç dhe Podujevë.

Më shumë se gjysma e tyre (65%) që morren pjesë në takimet në Prishtinë kanë deklaruar se ata ndjejnë se ndërtesat e komunave prej të cilave ata vijnë, janë të hapura për ata. Sidoqoft, romët posaqërisht, deklarojnë se për ata ndërtesat e komunave nuk janë gjithmonë të hapura. Nëpër komunat me numër të vogël të popullsisë, grupet e minoriteteve ndihen më të izoluar se në vendet tjera. Kroatet nga Lipjani, komuniteti më i vogël, ishte komuniteti i cili më së paku dëshironte të shprehë pikëpamjet hapur. Kjo është mbështetur edhe nga të gjitha komunitet e tjera për të pasur më tepër kontakte me të punësuarit

në komunë. Marrëdhëniet në mesë të të gjitha grupeve dhe përfaqësuesëve të tyre u panë si pozitive. Ofrimi i përgjithshëm i shërbimeve është parë në përgjithësi si "shumë i dobët", me një përjashtim të shënuar në komunën e Obiliçit ku ka pasur një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, që konsiderohet si një standard mesatarë. Disa grupe pranuan se qeveria lokale ballafaqohet me kufizimet e posaqërisht me faktin se ka një buxhet të vogël. Ashkalinjtë, romët dhe kroatët e këtij regjioni i kanë vlerësuar shërbimet publike kështu: (shih tabelën më poshtë.)

Shërbimi Minoriteti	Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik	Furnizimi me ujë	Menaxhimi i mbeturinave	Rrugët lokale	Transporti lokal	Kujdesi mjekësor	Mirëqenia sociale
Ashkallitë	1.45	2.00	1.90	1.60	2.15	2.65	2.00
Ashk/Romë	2.77	2.40	2.37	2.07	2.40	3.12	2.15
Kroatët	1.1	1	1	1	1	2.2	1.3
Romët	1.32	1.25	1.47	2.15	1.75	2.10	1.07

1 : shumë dobët 2 : dobët 3 : mesatar 4 : mirë 5 : shumë mirë

Fushë Kosovë

Një grup i këtueshëm i përbërë vetem nga ashkallitë, konsideron se këtu ndërtesa e komunës për ta është më pak e hapur se sa për një grup të përzier romë¹⁶/ashkali. Nga grupi i përbërë nga ashkallitë, pjesëmarrësit kanë vizituar shumë më rrallë komunën se sa ata nga grupi i përzier. Sidoqoft të dy grupet i vlerësuan shërbimet publike si shumë të dobëta në përgjithësi. Përkujdesi shëndetësorë është vlerësuar me një mesatare më të mirë. Furnizimi me ujë dhe gjendja e rrugëve lokale janë vlerësuar si shërbimet më të dobëta. Të dy grupet flasin pozitivisht për komunikimin dhe edukimin në gjuhën amtare por

disa prej tyre shprehin frikë për sigurinë, që do të thote se jo të gjithë kanë çasje në edukim. Shumica theksojnë se aktivitete kulturore nuk janë organizuar nga komuna por shpresojnë se kjo do të ndryshojë së shpejti. Papunësimi është gjithashtu një brengë e madhe e këtyre komuniteteve. Edhe pse është e qartë se vetem disa pjestarë të këtyre komuniteteve punojnë, kanë pozita në komunë, ata shprehen se janë të përfaqësuar në mënyrë adekuate përmesë anëtarëve të kuvendit komunal dhe të komitetit për komunitete.

Lipjan

Të dy grupet e vizitura në këtë projekt, **romët**¹⁷ dhe **kroatët**, deklarojnë se komuna e Lipjani nuk është e hapur për ta, kryesisht për mungesë të transportit.

Si pasojë e kësaj, 84% të tyre thonë se nuk e kanë vizituar fare komunën gjatë vitit të kaluar. Transportimi dhe pamundësia e lëvizjes së lirë janë në krye të listës

¹⁶ Romët në Fushë Kosovë i flasin të tri gjuhët, atë rome, shqipe dhe serbe. Duke pasur parasysh se popullata shumicë e Fushë Kosovës është shqipëtare, romët flasin më tepër shqip.

¹⁷ Në Lipjan romët flasin gjuhën rome dhe shumica flasin serbisht.

së prioriteteve të komuniteteve. Rrugët lokale shënuan vleren më të lartë edhe pse të klasifikuara si "dobët". Të dy grupet theksuan se komunikimi në gjuhën amtare me personelin e komunës nuk është i mundur dhe se dokumentet zyrtare dhe shenjat publike nuk janë në gjuhën e tyre amtare.

Përgjithësisht shërbimet publike në Lipjan konsiderohen si më të dobta në tërë regjionin e Prishtinës. Furnizimi me ujë është vlerësuar si njëra nga gjërat që i duhet një përmirësim i domosdoshëm paralel me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe me ndihmat sociale.

Komuniteti kroat theksuan se edukimi parashkollor dhe fillor për fëmijet e tyre ekziston por jo edhe edukimi i mesëm. Por më e rëndësishme është se aktivitete kulturore nuk organizohen fare nga komuna. Ata shprehin mosbesim tek të gjithë përfaqësuesit komunal (tek ndërkombëtarët dhe kombëtarët) dhe theksojnë se

askush prej tyre nuk ka ndonjë pozitë në komunë, prapëseprap ata ndiejn se janë të përfaqësuar mirë në kuvendin komunal dhe në komitetin për komunitete.

Komuniteti romë kritikon se nuk ka fare edukim në gjuhën amtare në asnjë shkallë për fëmijet e tyre. Sidoçft, edhe një herë, kjo çështje për ta nuk ka rëndësinë siç e ka satusi i tyre shoqëror. Ata nuk shprehin pakënaqësi drejtpërdrejt për mosorganizimin e aktiviteteve kulturore për ta nga komuna. Ata pajtohen se një aksion kolektiv do të mund të ua zgjidhte disa nga problemet e tyre, posaqërisht përmes përfaqësuesëve të tyre të zgjedhur. Ata nuk janë mirë të përfaqësuar dhe nuk ndihen të përfaqësuar për momentin. Papunësia është një brengë e madhe për këtë komunitet si dhe mungesa në përgjithësi e kushteve normale të jetes, posaqërisht mungesa e sistemit të kanalizimit.

Obiliq

Grupi i **romëve¹⁸ dhe ashkalive** në Obiliq shprehet se nuk kanë çasje në komunë. Shumica e pjesëmarrësëve (63%) nuk e kanë vizituar komunën as edhe një herë vitin e kaluar. Shërbimet publike janë vlerësuar si të dobëta, por si regjion në tërësi, janë më të mira se në komunat tjera. Rrugët lokale dhe transporti publik konsiderojnë se kanë nevojë për një vëmendje më të madhe.

I tërë komuniteti ndien se është mirë i përfaqësuar edhe në kuvendin komunal edhe në komitetin për komunitete dhe theksojnë se disa romë dhe ashkali punojnë në kuvend por jo si nëpunës komunal. Ata kanë besim tek

zyrtarët e tyre por thonë edhe këtë se nuk kanë kontakte të mira me komunën. Ekzistojnë ndjenja të përziera sa i përket mundësisë së komunikimit në gjuhën amtare edhe pse shumica pajtohen se kjo është e mundëshme dhe se dokumentet dhe shenjat publike nganjëherë janë në gjuhët e tyre amtare¹⁹. Dy të tretat e grupit (66%) ndiejnë se edukimi në gjuhën amtare për fëmijet e tyre ekziston në shkallen e parashkollorve dhe atë fillore, por vetëm një e treta (33%) prej tyre pajtohen për shkallen e mesme. Më se 70% të tyre pajtohen se komuna ka organizuar aktivitete kulturore për ta por ata kërkojnë më tepër.

Podujevë

Komuniteti i ashkalinjëve dhe një **grup i përzier ashkali/romë²⁰** i Podujevës i vlerësojnë shërbimet publike më lartë se sa komunitetet tjera të komunave tjera të regjionit të komunës së Prishtinës. Posaqërisht përkujdesi mjekësorë është "i mirë". Si shtesë, të dy grupet deklarojnë se ndërtesa e komunes është e hapur për ta dhe shumica e kishin vizituar këtë më shumë se tri herë mbrenda vitit të kaluar. Papunësimi, posaqërisht i rinisë, është njëra nga brengat të cilat paraqesin prioritet. Rrugët lokale dhe ndihmat sociale konsiderohen si më pak pozitive edhe pse mungesa e furnizimit me ujë dhe rrymë elektrike për këto komunitete janë disa nga brengat më të mëdha. Të dy grupet theksojnë se janë mirë të përfaqësuar në kuvendin komunal dhe në komitetin për komunitete, edhe përkundër shprehjes së mosbesimit për përfaqësimin e tyre për kohën që po jetojmë. Ata theksoj

edhe faktin se disa ashkali/romë janë të punësuar në komunë edhe si personel edhe si delegatë. Gjithashtu, ata shprehin se komunikimi në gjuhën amtare në komunë nuk është i mundur dhe se dokumentet zyrtare dhe shenjat publike në gjuhën e tyre nuk ekzistojnë. Dy të tretat e pjesëmarrësëve shprehin se edukimi i shkallës së mesme në gjuhën e tyre amtare ekziston²¹. Si shtesë, shumica prej tyre shprehin se komuna nuk ka organizuar aktivitete kulturore posaqërisht për ta por përgjithësisht pajtohen se janë organizuar aktivitete ndërkulturore.

¹⁸ Përsëri edhe në Obiliq romët flasin gjuhën rome dhe serbisht

¹⁹ Pasi që takimi në Obiliq është mbajtur në kampin e Plemetinës ku romët dhe ashkallit që jetojnë në të vijnë nga pjesë të ndryshme të Kosovës, ndjenjat e përziera sa i përket komunikimit publik dhe edukimit mund të sqarohen me faktin se disa romë flasin edhe serbisht përveç gjuhës rome.

²⁰ Në Podujevë romët flasin gjuhën rome dhe shumica e tyre flasin edhe gjuhën shqipe.

²¹ Në këtë rast kjo i referohen kryesisht gjuhës shqipe ngase kjo gjuhë, përveç gjuhës rome, përdoret nga shumica e ashkalive dhe romëve në Podujevë


Romët në komunën e Prishtinës pajtohen se kanë çasje në qeverinë lokale dhe se shumica prej tyre (70%) kanë vizituar komunën tri herë gjatë vitit të kaluar dhe tregojnë me bindje të thellë se kanë mundur të bëjnë këtë. Por, sikurse edhe me grupet e tjera të romëve, edhe romët e këtushëm theksojnë mungesën e komunikimit në gjuhën amtare me personelin e komunes dhe mungesën e dokumenteve zyrtare dhe shenjave publike. Si shtesë kësaj, edukimi në gjuhën amtare nuk ekziston. Grupi thekson se aktivitete kulturore janë organizuar për ta por nuk ka pasur aktivitete ndërkulturore. Romët ndiejnë se nuk janë si duhet të përfaqësuar. Në

Graçanicë ata theksojnë se të drejtat e tyre nuk janë përmirësuar në asnjë drejtim. Ata pajtohen se duhet të kenë përfaqësues të zgjedhur për bashkpunim me komunën dhe se përfshirja kolektive në zgjedhjen e problemeve do të ishte më frytdhënëse. Të gjitha grupet theksojnë se kanë anëtarë të komunitetit që punojnë si personel i komunës. Edhe një herë përkujdesi shëndetsorë është vlerësuar si më i miri (edhe pse ende i dobët) përdërisa ndihma sociale është vlerësuar si më pak pozitivja. Në përgjithësi, papunësia dhe situata ekonomike ende mbeten brengat kryesore.


Vështrimet rreth shërbimeve specifike për minoritetet në regjionin e Prizrenit

Një vështrim i përgjithshëm për shërbimet publike dhe shërbimet specifike të minoriteteve, në këtë regjion jepet në grafikonet e mëposhtme. Këto grafikone janë nxjerrur nga të dhënat e marra si përgjegjëje të anëtarëve të komuniteteve të minoriteteve në këtë regjion ku janë përfshirë kroatët, ashkalishtë dhe romët. Diagramët e mëposhtëm tregojnë (1) shkallën e përdorimit të gjuhëve të minoriteteve publikisht, (2) mundësinë e edukimit në gjuhën amtare dhe (3) numrin e ngjarjeve kulturore ashtu siq e kanë parë dhe theksuar komunitetet e minoriteteve për të cilat bëhet fjalë (në grafikonet e mëposhtme paraqiten, në përqindje, përgjegjet në pyetjet e caktuara).


Përdorimi publik i gjuhëve të minoriteteve nëpër komunitete



Edukimi në gjuhën e tyre amtare nëpër komunitete



Ngjarjet kulturore nëpër komunitete



Vlenë të shenohet se në takimin regional të organizuar në fazën e tretë të këtij projekti, ku pjesëmarrësit nga grupet etnike komentuan vlerësimet e paraqitura të shërbimeve të përgjithëshme në lidhje me kushtet jetësore dhe të shërbimeve specifike për minoritetet të cilat duhet të i ofroj komuna. Çështja e pjesëmarrjes së anëtarëve të minoriteteve në strukturat komunale²² nuk është përfshirë në diagrame për shkak të informatave të pasakta dhe për shkak të pasigurisë së përgjegjëjeve të atyre me të cilët është bërë intervista.

U moren këto komente:

- shkalla e përkujdesit shëndetsorë në komunën e Obiliçit është vlerësuar shumë e lartë dhe joreale (të gjithë pjesëmarrësit)
- edukimi në gjuhën amtare është vlerësuar realisht (të gjithë pjesëmarrësit)
- duhet të shenohet se romët e intervistuar kanë vlerësuar edukimin në gjuhën amtare si zero (një romë nga Obiliçi dhe Graçanica)
- vlerësimi i ngjarjeve kulturore nuk është fare korrekt. Komuna nuk ka organizuar asnjë ngjarje për komunitetet etnike. Të gjitha ngjarjet janë të organizuara nga vetë komunitetet (të gjithë pjesëmarrësit).

²² Për informatat shtesë dhe referencat, për pjesëmarrjen e minoriteteve në pushtet lokal, shih në lexim të mëtuqjeshëm.

Konkluzat dhe rekomandimet

Në përgjithësi është me rëndësi të theksohet se informatat e mbledhura dhe të shpërndara përmes kësaj fletushke duhet të konsiderohen si informata të dorës së parë, të mbledhura nga vetë komunitetet. Fjala është, për një kompilim të dëshirave, pikëpamjeve, komenteve dhe shqetësimeve të komuniteteve të vizituara gjatë rrjedhës së këtij projekti. Poshtu, është mirë të vihet në dukje se ca prej tyre janë thjesht koncepte të gabuara, të cilat burojnë nga vetë situata e një shoqërie në tranzicion.

Megjithatë, mund të nxirren disa konkluzione, të cilat duhet t'u shërbejnë autoriteteve lokale, në të ardhmen, si bazë për përmirësimin e gjendjes dhe funksionimit të vetëqeverisjes lokale, në mesin e pjesëtarëve të ndyshëm të komuniteteve që nuk i takojnë shumicës.

Prandaj, ky dokument ka për qëllim që të nxisë një proces të vazhdueshëm të konsultimeve me liderët dhe përfaqësuesit e komuniteteve. Shpresohet se këto informata do të cysin ide të reja për përmirësimin e gjendjes dhe do t'i motivojë qeveritë lokale që t'i ngrisin çështjet (preokupimet) e vërteta të banorëve të Kosovës së sotme, me qëllim që ta përshpejtojnë procesin e ndërtimit të një shoqërie krejtësisht demokratike, të lirë dhe tolerante.

- Nëse administratat komunale nuk ia dalin mbanë t'u komunikojnë ato veprime komuniteteve të tyre përkatëse, atëherë ata duhet të dijnë për këte. Informatat e mbledhura dhe të krahasuara këtu nuk duhet të konsiderohen si kritikë, por më tepër si një mjet konstruktiv për t'i udhëzuar punonjësit e administratës komunale në punën e tyre të mëtuajtshme.

- Sipas kësaj informate, është e qartë se komunitetet më të vogla të minoriteteve në Kosovën e ditëve të sotme, ndihen të izoluar dhe të injoruar nga qeveritë lokale. Sa më të vogla të jenë komunitetet e tyre, aq më pak kanë besim ato që ta shprehin shqetësimet e tyre për izolim. Së këndejmi, frika për cenimin e ekzistencës së tërë komunitetit është gjithnjë në rritje. Në këtë mënyrë, aktivitetet kulturore bëhen më të rëndësishme se çdo çështje tjetër për këto komunitete dhe njëkohësisht, ato mund të shërbejnë si një fillësë e dobishme për secilën komunë që t'i sigurojë qytetarët e saj, se ata janë të përfshirë në jetën e komunës aq sa edhe populli shumicë.

- Për më tepër, komunitetet më të izoluar dhe më të vogla mbështeten shumë më tepër, në ndihmën nga jashtë, se sa në forcat vetanake, për të mbijetuar. Kjo kulturë (shprehi) e varshmërisë do të rritet, meqë komunitetet po mësohen gjithnjë e më tepër me mirëqenie sociale, gjë e cila paqyrohet në zonat me papunësinë më të madhe, të cilat e konsiderojnë ndihmën për përmirësimin e mirëqenies sociale si prioritet të tyre kryesor. Këto zona janë njëkohësisht edhe zonat që kanë fare pak apo edhe aspak pjesëmarrje në aktivitete (jetën) politike. Kjo përsëri provon mungesën e besimit për vetëiniciativë. Në vend të kësaj, komunitetet më së paku të prezentuara, fillojnë të kërkojnë asistencën ndërkombëtare, më përpara se të kërkojnë ndihmën (veprimin) e palës tjetër.

Ju lutemi të keni parasyshë se rekomandimet i kanë bërë vetë pjesëmarrësit në dy javët e fundit të gushtit 2002, në pesë takimet regjionale. Ato nuk paraqesin qendrimet e OSBE-së lidhur me këto çështje.

KOMUNIKIMI NË GJUHË AMTARE/PËRDORIMI I GJUHËS SË MINORITETEVE HAPTAZI

1. Në Komunitat ku gjuha e minoriteteve është e pranuar si gjuhë zyrtare,²³ emrat e vendeve, shenjat publike dhe dokumentet zyrtare duhen të ekzistojnë në gjuhën e minoriteteve. Veç kësaj, minoritetet gjithashtu duhet të gëzojnë mundësinë të përdorin gjuhën e tyre gjatë komunikimit në ndërtesën e Komunës pasi që shpesh ndodh që ato të kuptojnë gjuhën shqipe dhe sërbe mirëpo nuk mund të flasin apo shkruajnë në këto gjuhë me saktësi. Me pak fjalë, të drejtat e minoriteteve të garantuara me Ligjin e Zbatueshëm,²⁴ duhet të zbatohen me efikasitet.
 2. Përdorimi i gjuhës së minoriteteve haptazi nuk duhet të vonoj edhe më tutje sepse mund të ndodh që momenti për paraqitjen e përdorimit të gjuhës së minoriteteve haptazi mund të humbet. Kjo do të rezultojë në zhgënjim të mëtutjeshëm dhe shpërngulja e këtyre bashkësive minoritare mund të vazhdojë.
 3. Ndërprerja/jovazhdimësia e të drejtave që kishin ekzistuar më parë ("të drejtat e siguruara") në përdorimin e gjuhës së minoriteteve haptazi rrit tensionet ndëretnike dhe rezultojnë në kufizim të zmadhuar të të gjitha minoriteteve në fjalë. Gjatë hartimit të ligjeve, rregullave dhe rregulloreve dhe gjatë themelimit të praktikave të reja duhet të merren parasysh edhe traditat dhe praktikatat pozitive nga e kaluara.
1. Komunitat duhet të punësojnë një nëpunës për regjistrim që mund të përdor gjuhën dhe alfabetin e minoriteteve kyçe në mënyrë korrekte dhe t'i shqiptoj emrat e individëve që janë pjesëtarë të bashkësive të ndryshme minoritare saktësisht si në letërnjoftimet e reja ashtu edhe në dokumentet tjera zyrtare.
 2. Organizatat ndërkombëtare të pranishme në Kosovë kanë bërë gabime të dukshme në mohimin e përdorimit të gjuhës së minoriteteve haptazi. Ato rrallëherë, ose edhe asnjëherë, e kanë përdorur gjuhën e minoriteteve në dokumentet e veta zyrtare. Për shembull pjesëtarët e bashkësisë Turke thonë se nuk ka ekzistuar asnjë herë gjatë këtyre tre viteve të fundit kur ato kanë marrë ndonjë dokument zyrtar në gjuhën e vet. Organizatat ndërkombëtare në Kosovë e sidomos Misioni i Përkohshëm Administrativ i Kombeve të Bashkuara (UNMIK-u) dhe Misioni i OSBE-së në Kosovë të cilët janë vepruesit kryesor në ndërtimin e institucioneve duhet të jenë shembuj pozitiv për përdorimin sistematik të gjuhës së minoriteteve haptazi.

ARSIMI NË GJUHËN AMTARE

1. Pas konfliktit të vitit 1999 shumë bashkësi minoritare u detyruan të ballafaqohen me ndërprerjen e shkollimit në gjuhë amtare të niveleve të ndryshme. Mungesa e qasjes në kualifikim profesionist dhe shkollim më të lartë e nxiti kufizimin e mëtutjeshëm. Andaj është e domosdoshme që Komunitat të themelojnë klasë shtesë si dhe kurse me shkallë speciale në gjuhët amtare të bashkësive etnike që janë në situatë të pafavorshme. Këto përgatitje do të mund të përfshinin edhe universitetet e hapura dhe kurse intenzive për aftësim profesionist.
2. Sigurimi i arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm është nën kompetencat e Komunës. Sidoqoftë ato duhet të marrin funksionin e atyre që ndikojnë në qeverinë e përkohshme në nivelin qendror për themelimin e arsimit më të lartë për bashkësitë e veta minoritare.²⁵ Minoritetet do të stimulohen të qëndrojnë vetëm nëpërmes të përparimit të arsimit më të lartë dhe të mundësive për punësim.
3. Komunitat ku jetojnë bashkësitë minoritare josërbe ku ndjekja e arsimit të ulët është në shkallë tejet të ulët, ajo komunë duhet të ndërmerr masa përkatëse që të bëjë ndjekjen e shkollës të detyrueshme dhe në rast nevojë të caktohen dënime për prindërit e pakujdesshëm.
4. Përdorimi i gjuhës Rome në Kosovë në përgjithësi është në rënie. Fondacionet e arsimit në gjuhë Rome duhet të rithemelohen nga Komunitat, siç edhe ka qenë rasti para konfliktit të vitit 1999. Kjo kërkon themelimin e kurseve për aftësim të mësuesve në gjuhë Rome si dhe sigurimin e teksteve shkollore në gjuhën rome për nxënësit.

²³ Shih Shtojcën III për të parë gjuhët zyrtare të komunave të anketuara.

²⁴ Shih Kapitullin 4 Nenin 4.4. (a) të Kornizës Kushtetuese dhe Seksionin 9 të Rregullores së UNMIK-ut me nr. 2000/45 si dhe Statutin e Komunës.

²⁵ Një hap pozitiv në këtë drejtim është hapja e shkollës së biznesit në gjuhën boshnjake në kuadër të fakultetit të Pejës më 1 tetor të vitit 2002.

5. Në kampet e personave të zhvendosur përbrenda Kosovës minoritetet josërbe që flasin gjuhë të ndryshme shpeshherë detyrohen të mësojnë në një gjuhë të vetme. Atyre duhet t'u jipet mundësia të mësojnë në gjuhën e vet. Përvoja tregon se arsimi në gjuhë të huaj sjell rezultate të ulëta ose fare pak. Kjo e rrit analfabetizmin dhe braktisjen e shkollës. Andaj i demotivon prindërit dhe në planin afatgjatë e përforcon kufizimin e bashkësive minoritare në fjalë.

KULTURA

1. Të gjitha minoritetet kanë shprehur kërkesë të fuqishme që ngjarjet kulturore të financohen dhe organizohen nga Komunitatet. Megjithatë në përgjithësi pranohet fakti që ka mungesë të llahtarshme të infrastrukturës për një organizim të qëndrueshëm të këtyre ngjarjeve.
2. I bëhet thirrje komunave për themelimin e qendrave kulturore për minoritetet në veçanti për rininë.

PJESËMARRJA E MINORITETEVE NË QEVERINË LOKALE

Punësimi

1. Pjesëtarët e bashkësive josërbe thonë se përqëndrimi kryesor i vihet punësimit nëpër qeveri lokale të individëve që janë pjesëtarë të bashkësisë serbe ashtuqë minoritetet më të vogla janë të mohuara në përgjithësi.²⁶ Si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal të Shërbimit Civil të Kosovës duhet të themelohet një qasje gjithëpërfshirëse e përfaqësuesve. Numri i shërbyesve civil të minoriteteve në kuadër të komunave duhet të pasqyroj përbërjen etnike lokale sipas marrëveshjes në mes të bashkësive kyçe lokale.
2. Organizatat ndërkombëtare që janë të pranishme në Kosovë duhet të rrisin dukshëm shkallën e punësimit të pjesëtarëve të minoriteteve josërbe pasi që përvoja tregon se numri i tyre në këto organizata është shumë më i ulët se sa që ua lejojnë kualifikimet e tyre profesionale. Këto organizata duhet të jenë shembuj pozitiv për institucionet lokale. Gjatë procesit të rekrutimit të pjesëtarëve të minoriteteve duhet t'i vihet vëmendje vetidentifikimit pasi që identiteti etnik nuk mund të kuptohet vetëm në bazë të emrit. Në rast se identiteti i një individi është në pyetje atëherë duhet të konsultohen organizatat/shoqatat që merren me minoritetet dhe që janë të regjistruara zyrtarisht. Organizatat përkatëse e në veçanti UNMIK-u duhet të vendos një proces transparent të konsultimit rreth këtyre çështjeve me organizatat legjitime të minoriteteve.
3. Duhet t'i vihet vëmendje e veçantë punësimit të pjesëtarëve të minoriteteve më të cenuara, siç është bashkësia Rome, në shërbimin civil.

Masat speciale për përfaqësimin e minoriteteve në nivelin lokal

1. Sistemi zgjedhor proporcional nuk mjafton për të arritur përfaqësim domethënës të bashkësive minoritare në nivelin lokal. Sistemi i tanishëm zgjedhor lejon zgjedhjen e një numri të vogël të përfaqësuesve të minoriteteve votat e të cilëve mund të munden lehtë nga votat e shumicës në Kuvendin Komunal. Andaj duhet të bëhen marrëveshje përbrenda ligjit zgjedhor në mënyrë që të sigurohet pjesëmarrja e tyre efikase në qeveri. Këto masa mund të përfshijnë marrëveshje numerike dhe procedurale dhe duhet të zhvillohen në konsultim me përfaqësuesit legjitim të minoriteteve.
2. Ka mosmarrëveshje në mes të minoriteteve josërbe sa i përket domethënies dhe efikasitetit të sistemit të emërimit apo të ulësive të rezervuara për përfaqësuesit të minoriteteve pranë Kuvendeve Komunale. Në anën tjetër minoritetet më të mëdha dhe më të organizuara thonë se duhet të vazhdoj të përdoret sistemi zgjedhor proporcional pasi që shumica prej tyre kishin përvoja tejet negative me përfaqësuesit e tyre që ishin të emëruar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm. Është thënë se shpeshherë ka ndodhur që përfaqësuesit e emëruar aspak nuk i kishin mbështetur interesat e minoriteteve përkundrazi ata kanë qenë të përqëndruar më

²⁶ Duhet vënë re se përfaqësuesit e minoritetit boshnjak në rajonin e Pejës shprehën kënaqësi rreth punësimit të pjesëtarëve të bashkësisë boshnjake në shërbimin policor të Kosovës.

shumë në promovim personal. Andaj bashkësitë minoritare dëshirojnë të ushtrojnë kontrollë demokratike mbi përfaqësuesit e vet. Në anën tjetër bashkësitë më të vogla minoritare që janë më pak të mobilizuara kërkojnë fuqishëm vazhdimin e sistemit të emërimit ngase ky është i vetmi sistem që u mundëson atyre ngritjen e interesave të vet në nivelin e qeverisë lokale. Sidoqoftë nëse sistemi i ulëseve të rezervuara do të zbatohet sërish duhet të bëhet nëpërmes të një procesi transparent të emërimit në bashkëpunim me përfaqësuesit legjitim të bashkësive minoritare në fjalë në mënyrë që të reduktohet përfaqësimi i gabuar i interesave të minoriteteve.

3. Vetëm nëpërmes të marrëveshjeve speciale për minoritetet në nivelin lokal mund të evitohet krijimi i tensionimit në mes të nivelit qendror të Qeverisë shumëetnike dhe qeverisë lokale të dominuar nga shumica.

DISKRIMINIMI

1. Komunitat duhet të ndërmarrin masa konkrete në mënyrë që mos të ndodh asnjë formë e diskriminimit sistematik në baza të gjinisë, racës, ngjyrës, gjuhës, religjionit, mendimit politik apo të ndonjë lloji tjetër, prejardhjes kombëtare apo shoqërore, shoqërimin me një minoritet kombëtar, pronësisë, statutit të lindjes apo të ndonjë statuti tjetër në institucionet publike që janë nën kompetencat e komunës.

KTHIMI

1. Komunitat duhet t'i japin vëmendje të njëjtë të gjitha minoriteteve kur është në pyetje çështja e kthimit duke përfshirë rindërtimin e shtëpive, çështjet e pronësisë dhe mundësitë për punësim. Përvoja ka treguar që në disa komuna në mënyrë të ashpër kthimi i disa minoriteteve është bërë më parësor se kthimi i të tjerëve. Ankesa e bashkësisë Boshnjake në komunën e Prizrenit është njëri ndër rastet e tilla.

Lista e mbledhjeve të mbajtura me bashkësitë minoritare në pesë rajonet e Kosovës

Mbledhjet ishin të organizuara nga Fondacioni Ndërkombëtar për Sistemet Zgjedhore (IFES) gjatë periudhës në mes të 21 qershorit - 2 korrik të vitit 2002

Rajoni i Pejës

- Komuna e Pejës – Pejë – Bashkësia Rome
- Komuna e Pejës – Vitomiricë – Bashkësia Boshnjake
- Komuna e Pejës – Zillopek – Bashkësia Boshnjake
- Komuna e Deqanit – Gramaqel – Bashkësia Egjiptiane
- Komuna e Deqanit – Pemishte/Hereq – Bashkësia Egjiptiane
- Komuna e Deqanit – Pemishte – Bashkësia Egjiptiane
- Komuna e Istogut – Gusar – Bashkësia Egjiptiane
- Komuna e Gjakovës – Koloni – Bashkësia Egjiptiane

Rajoni i Gjilanit

- Komuna e Ferizajit – Dubravë 2 – Bashkësia e Ashkalive
- Komuna e Ferizajit – Sallahane – Bashkësia Rome dhe e Ashkalive
- Komuna e Ferizajit – Bashkësia e Ashkalive
- Komuna e Ferizajit – Dubravë – Bashkësia e Ashkalive
- Komuna e Ferizajit – Bashkësia Rome
- Komuna e Ferizajit – Sallahane – Bashkësia Rome
- Komuna e Ferizajit – Sallahane – Bashkësia e Ashkalive
- Komuna e Ferizajit – rr. Ali Ibishi – Bashkësia e Ashkalive
- Komuna e Gjilanit – Dobërçan – Bashkësia Turke
- Komuna e Gjilanit – Gjilan – Bashkësia Rome
- Komuna e Novo Bërdës – Bostane – Bashkësia Rome
- Komuna e Vitisë – Vërbovac – Bashkësia Rome

Rajoni i Mitrovicës

- Komuna e Mitrovicës – Kampi i Romëve – Bashkësia Rome
- Komuna e Mitrovicës – Mitrovicë – Bashkësia e Goranëve/Boshnjakëve
- Komuna e Mitrovicës – Bashkësia e Romëve
- Komuna e Mitrovicës – Mitrovica Veriore – Bashkësia Boshnjake
- Komuna e Mitrovicës – Mitrovica Veriore – Bashkësia Boshnjake 2
- Komuna e Mitrovicës – Mitrovica Veriore /Qesmin Lug – Bashkësia Rome
- Komuna e Mitrovicës – Mitrovica Jugore – Bashkësia Boshnjake
- Komuna e Mitrovicës – Mitrovica Jugore /2 Korriku – Bashkësia e Ashkalive
- Komuna e Mitrovicës – Bair – Bashkësia Boshnjake
- Komuna e Mitrovicës – Mitrovica Jugore – Bashkësia e Goranëve
- Komuna e Mitrovicës – Mitrovica Jugore – Bashkësia Turke
- Komuna e Leposaviqit – kampi Leposaviq – Bashkësia Rome
- Komuna e Leposaviqit – Rvatskë – Bashkësia Boshnjake

- Komuna e Vushtrrisë – Vushtrri – Bashkësia e Ashkalive
- Komuna e Vushtrrisë – Bukosh – Bashkësia e Ashkalive
- Komuna e Vushtrrisë – Stanovci i Ulët – Bashkësia e Ashkalive
- Komuna e Vushtrrisë – Vushtrri – Bashkësia Turke
- Komuna e Zveçanit – kampi Zhitkovac – Bashkësia Rome
- Komuna e Zveçanit – kampi Zhitkovac – Bashkësia Rome 2

Rajoni i Prizrenit

- Komuna e Prizrenit – Prizren – Bashkësia Boshnjake
- Komuna e Prizrenit – Mamushë – Bashkësia Turke
- Komuna e Prizrenit – Mamushë – Bashkësia Turke 2
- Komuna e Prizrenit – Prizren – Bashkësia Rome
- Komuna e Prizrenit – Lubinjë e Epërme – Bashkësia Boshnjake
- Komuna e Prizrenit – Lubinjë e Epërme – Bashkësia Boshnjake 2
- Komuna e Prizrenit – Mushnikovë – Bashkësia Boshnjake
- Komuna e Prizrenit – Pllanjanë – Bashkësia Boshnjake
- Komuna e Prizrenit – Reçanë – Bashkësia Boshnjake
- Komuna e Prizrenit – Bitol – Bashkësia Rome
- Komuna e Prizrenit – Prizren – Bashkësia Rome 3
- Komuna e Prizrenit – Prizren – Bashkësia Rome 2
- Komuna e Prizrenit – Prizren – Bashkësia Turke
- Komuna e Prizrenit – Prizren – Bashkësia Turke 2
- Komuna e Dragashit – Globoçicë – Bashkësia e Goranëve 1
- Komuna e Dragashit – Globoçicë – Bashkësia e Goranëve 2
- Komuna e Dragashit – Vranishtë – Bashkësia e Goranëve

Rajoni i Prishtinës

- Komuna e Prishtinës – Prishtinë - Bashkësia Rome dhe e Ashkalive
- Komuna e Prishtinës – Graçanicë – Bashkësia Rome
- Komuna e Prishtinës – Graçanicë – Bashkësia Rome 2
- Komuna e Prishtinës – Graçanicë – Bashkësia Rome 3
- Komuna e Fushë Kosovës – Fushë Kosovë – Bashkësia Rome dhe e Ashkalive
- Komuna e Fushë Kosovës – Lagjja 28,29 – Bashkësia e Ashkalive
- Komuna e Lipjanit - Janjevë – Bashkësia Kroate
- Komuna e Lipjanit – Livadje – Bashkësia Rome
- Komuna e Obiliqit – kampi i Plementinës – Bashkësia Rome dhe e Ashkalive
- Komuna e Podujevës – Podujevë - Bashkësia e Ashkalive dhe Rome
- Komuna e Podujevës – Batllava – Bashkësia e Ashkalive

Bashkangjtitja/Zërat e Minoriteteve**Pyetësori**

Komuna:

Data:.....

Pjesa I Të Dhënat Biologjike			
Mosha:	Gjinia: F M	Numri i fëmijëve:	A i përkisni Komunitetit të Minoriteteve? Nëse po, cilës: (sipas zgjedhjes)
Pozita martesore:			Emri i Fshatit, Qytezës apo Qytetit:
I/e pamartuar	I/e martuar	I/e shkurorezuar	I/e ve
Arsimi:			I punësuar? (shenjëzoni) Po Jo
Shkollimi fillor	Shkollimi i mesëm	Universiteti	Profesioni:

Pjesa II Informata të përgjithshme për Komunën Tuaj						
1. A ka ndërtesa e komunës çasje të lehtë? <input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo						
Nëse jo, ju lutem sqaroni (P.sh. shumë larg, nuk ka transport, arsye të tjera):						
2. Sa herë keni qenë në Komunë vitin e kaluar?						
<input type="checkbox"/> Asnjëherë <input type="checkbox"/> një <input type="checkbox"/> dy <input type="checkbox"/> tre <input type="checkbox"/> më shumë se tre						
3. Shërbimet		Shumë dobët	Dobët	Mesatare	Mirë	Shumë mirë
Zhvillimi ekonomik i qëndrueshëm						
Furnizimi me ujë						
Pastrimi i mbeturinave						
Rrugët lokale						
Transporti lokal						
Kujdesi shëndetësor						
Mirëqenia sociale						

Pjesa III Informatat Specifike për Minoritetet

1. Komunikimi në Gjuhën e Minoriteteve

- a. A mund të komunikoni në gjuhën tuaj me punëtorët civil të komunës? Po Jo
- b. A janë dokumentet zyrtare të shkruara edhe në gjuhën tuaj? Po Jo
- c. A janë shenjat zyrtare që shënojnë emrin e qytetit/fshatit tuaj të shkruara në gjuhën tuaj? Po Jo
- d. A janë shenjat zyrtare që shënojnë emrat e vendeve publike (P.sh. rrugët, institucionet publike) të shkruara poashtu në gjuhën tuaj? Po Jo
- e. Komentet

2. Arsimi

- a. A kanë fëmijët tuaj shkollim parashkollor në gjuhën tuaj? Po Jo
- b. A kanë fëmijët tuaj shkollim elementar në gjuhën tuaj? Po Jo
- c. A kanë fëmijët tuaj shkollim të mesëm në gjuhën tuaj? Po Jo
- d. Komentet

3. Kultura

- a. A ka organizuar Komuna juaj ngjarje të lidhura me kulturën tuaj? Po Jo
- b. A ka organizuar Komuna juaj ngjarje ndërkulturore të lidhura me kulturat lokale? Po Jo
- c. Komentet

4. Pjesëmarrja në Strukturat Komunale

- a. A është Komuniteti i juaj i përfaqësuar në Asamblenë Komunale? Po Jo
- Nëse po:
- A është përfaqësuesi i juaj i zgjedhur? Po Jo
 - A është përfaqësuesi i juaj i emëruar? Po Jo
 - A ka mundur ai/ajo ti përfaqësojë interesat e komunitetit tuaj? Po Jo
 - A është komuniteti i juaj i përfaqësuar në Komitetin e Komunave? Po Jo
 - A ka mundur ai/ajo ti përfaqësojë interesat e komunitetit tuaj? Po Jo
- b. A ka ndonjë pjesëtar të komunitetit tuaj që punon si punëtor civil në Komunën tuaj?
 Po Jo
- c. A ka ndonjë pjesëtar të komunitetit tuaj që punon në çfardo pozite në Komunën tuaj?
 Po Jo

Rajoni: **Pejë**

Gjuhët zyrtare dhe përfaqësuesit e minoriteteve josërbe

Komuna	Gjuhët zyrtare	Përfaqësuesit josërb	
		Të zgjedhur	Të emëruar
Pejë	Gjuha shqipe	1 SDA ¹	2 Boshnjak, 1 Egjiptas, 1 Romë
Dečan	Gjuha shqipe	1 Boshnjak	Nuk ka
Istog	Gjuha shqipe	1 SDA	1 Egjiptas, 1 Boshnjak (SDA)
Gjakovë	Gjuha shqipe	Nuk ka	2 Egjiptasë

Rajoni: **Prizren**

Gjuhët zyrtare dhe përfaqësuesit e minoriteteve josërbe

Komuna	Gjuhët zyrtare	Përfaqësuesit josërb	
		Të zgjedhur	Të emëruar
Prizren	Gjuha shqipe, boshnjake, sërbe, turke	2 BSDAK ² , 1 DRSM ³	1 Boshnjak, 1 Romë, 2 Turq
Dragash	Gjuha shqipe, boshnjake, sërbe	3 GIG ⁴ , 2 SDA	Nuk ka

Rajoni: **Mitrovicë**

Gjuhët zyrtare dhe përfaqësuesit e minoriteteve josërbe

Komuna	Gjuhët zyrtare	Përfaqësuesit josërb	
		Të zgjedhur	Të emëruar
Mitrovicë	Gjuha shqipe, sërbe	Nuk ka	1 Boshnjak nga Prishtina
Leposaviq	Gjuha sërbe	Nuk ka	1 Boshnjak (JUL) ⁵
Vushtrri	Gjuha shqipe, sërbe	Nuk ka	Nuk ka
Zveçan	Gjuha sërbe	Nuk ka	

1 Partia e Aksionit Demokratik

2 Partia Boshnjake e Aksionit Demokratik të Kosovës

3 Partia e Reformës Demokratike të Muslimanëve

4 Iniciativa e Qytetarëve Goranë

5 E Majta Jugosllave

Rajoni: **Gjilan**

Gjuhët zyrtare dhe përfaqësuesit e minoriteteve josërbe

Komuna	Gjuhët zyrtare	Përfaqësuesit josërb	
		Të zgjedhur	Të emëruar
Gjilan	Gjuha shqipe, sërbe	Nuk ka	1 Romë, 1 Turk, (KTDP) ⁶
Ferizaj	Gjuha shqipe, sërbe	Nuk ka	1 Ashkali, 1 Romë
Novo Bërdë	Gjuha shqipe, sërbe	Nuk ka	1 Romë
Viti	Gjuha shqipe	Nuk ka	1 Kroat

Rajoni: **Prishtinë**

Gjuhët zyrtare dhe përfaqësuesit e minoriteteve josërbe

Komuna	Gjuhët zyrtare	Përfaqësuesit josërb	
		Të zgjedhur	Të emëruar
Prishtinë	Gjuha shqipe, sërbe	Nuk ka	1 Ashkali (PDASHK) ⁷ , 1 Boshnjak (BSDAK), 1 Turk (KDTP)
Fushë Kosovë	Gjuha shqipe, sërbe	1 Ashkali (PDASHK)	
Lipjan	Gjuha shqipe, sërbe	Nuk ka	1 Ashkali, 1 Kroat, 1 Romë
Obiliq	Gjuha shqipe, sërbe		1 Ashkali (nuk dihet përkatësia politike)
Podujeva	Gjuha shqipe, sërbe	Nuk ka	1 Ashkali (nuk ka përkatësi politike - kandidat i pavarur)

⁶ Partia Demokratike Turke e Kosovës

⁷ Partia Demokratike e Ashkalive

Rekomandimet e Lundit për Pjesëmarrje Efektive të Pakicave Kombëtare në Jetën Publike

HYRJE

Me vendimet e Helsinkit në korrik 1992, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (OSBE) e vendosi postin e Komisarit të Lartë për Pakica Kombëtare si "instrument për parandalim të konflikteve në fazën sa më të hershme". Ky mandat u krijua kryesisht si reagim ndaj situatës në ish-Jugosllavi nga e cila u paraqit frika se ajo mund të përsëritet dikund tjetër në Evropë, në veçanti në shtetet në transicion kah demokracia, që do të shkatrronte tendencat për paqë dhe prosperitet të parashikuara në deklaratën e Parisit për Evropën të re, e miratuar nga kryetarët e shteteve dhe qeverive në nëntor 1990.

Në 1 janar 1993, z. Max van der Stoel e mori detyrën si Komisar i Lartë i Pakicave Kombëtare (KLPK) i OSBE. Duke absorbuar nga përvoja e tij e madhe si ish deputet në parlament, si Ministër i Punëve të Jashtme të Holandës, si përfaqësues i vazhdueshëm në Kombet e Bashkuara dhe një kohë të gjatë advokat për të drejtat e njeriut, z. van der Stoel përqëndroi vëmendjen e tij në shumë mosmarrveshje mes pakicave dhe pushteteve qendrore në Evropë të cilat sipas tij kishin potencial për të eskaluar. Duke vepruar qetë me mënyra diplomatike, KLPK u involvua në një varg shtetesh, duke përfshirë Shqipërinë, Kroacinë, Estoninë, Hungarinë, Kazahstanin, Kirgistanin, Lituaniën, ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Rumaninë, Sllovakinë dhe Ukrainën. Angazhimi i tij është përqëndruar kryesisht në ato situata të cilat involvojnë persona që u takojnë grupeve kombëtare/etnike të cilat përbëjnë shumicën numerike në një shtet por pakicën numerike në shtet tjetër, përfaqësuar kështu interesin e autoriteteve shtetërore në çdo shtet dhe duke krijuar burim potencial të tensioneve ndërshtetërore po qoftë edhe konflikte. Në të vërtetë këto tensione kanë definuar një pjesë të madhe të historisë evropjane.

Gjatë definimit të esencës të tensioneve që përfshijnë pakicat kombëtare, KLPK iu qaset çështjeve në mënyrë të pavarur, neutrale dhe me bashkëpunim. Gjersa KLPK nuk është mekanizëm mbikqyrës, ai përdor standarde ndërkombëtare ndaj të cilave është obliguar çdo shtet dhe të cilat ai i përdorë si kornizë kryesore për analiza dhe formulim të rekomandimeve të tij specifike. Rrjedhimisht është e rëndësishme të përkujtohen obligimet të marra nga të gjitha shtetet anëtare të OSBE-së, sidomos shtetet nënshkruese të dokumentit të Kopenhagës më 1990 nga konferenca për dimensionet njerzore i cili në pjesën IV i artikulon obligimet e detajshme që kanë të bëjnë me pakicat kombëtare. Është me rëndësi të përmendet se të gjitha shtetet e OSBE-së janë gjithashtu të detyruara nga obligimet e Kombeve të Bashkuara që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut duke përfshirë të drejtat e pakicave. Pjesa më e madhe e shteteve të OSBE-së janë edhe mëtej të detyruara nga standardet e Këshillit të Evropës.

Pas një aktiviteti intensiv gjashtëvjeçar, KLPK ka identifikuar çështje dhe tema të caktuara periodike që janë bërë objekt i vëmendjes së tij në një numër të konsiderueshëm të shteteve në të cilat ai është i involvuar. Arsimi i dhe përdorimi gjuheve të pakicave është me rëndësi të becante për mbajtjen dhe zhvillimin e identitetit të personave që u takojnë pakicave kombëtare. Për tu arritur aplikim i qëlluar dhe koherent i të drejtave relevante të pakicave në hapsirën e OSBE-së, në vjeshtë të vitit 1995 KLPK kërkoi nga Fondacioni për Marëdhënie Ndëretnike- një organizatë joqeveritare e formuar në 1993 për t'i realizuar aktivitetet e specializuara në përmbajtje të KLPK- që të angazhojë dy grupe të ekspertëve ndërkombëtarisht të njohur dhe të pavarur që të elaborojnë dy rekomandime:

- Rekomandimet e Hagës për të Drejtat e Pakicave për Arsim (1996) dhe
- Rekomandimet e Oslos për të Drejtat Gjuhësore të Pakicave Kombëtare (1998).

Në shumë shtete, këto dy rekomandimet kanë u kanë shërbyer si politikanëve ashtu edhe ligjdhënësve. Fondacioni për Marëdhënie Ndëretnike ka bërë përkthim në disa gjuhë dhe i shpërndan pa pagesë.

Tema e tretë dhe e përhershme në një numër situatash ku ka qenë i involvuar KLPK është ajo e pjesëmarrjes e pakicave kombëtare në qeverisjen e shteteve. Për informim më të mirë rreth botkuptimeve të shteteve të OSBE-së për këtë çështje dhe me qëllim që t'i lejohet shteteve të këmbëjnë përvojat njëra me tjetrën, KLPK dhe zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut, organizuan konferencë të të gjitha shteteve të OSBE-së si dhe organizatave relevante ndërkombëtare të titullar "Qeverisja dhe Pjesëmarrja: Integrimi i Dallimeve" që u mbajt nga 18 deri më 20 tetor, në qytetin Lokarno të Konfederatës së Zvicrës. Në deklaratën e dhënë në fund nga kryetari i konferencës u rrumbullaksuan temat e takimit dhe u cek dëshira për "aktivitete konkrete rrjedhimore, duke ngërthyer elaborim të mëtejshëm të mekanizmave dhe koncepteve të ndryshme të qeverisjes të mirë me pjesëmarrje efektive të pakicave që do të mundësojë integrimin e dallimeve brënda shtetit". Rrjedhimisht KLPK angazhoi Fondacionin për Raporte Ndërtnike, në bashkëpunim me Institutin për të Drejtat e Njeriut dhe të Drejtën Humanitare të quajtur Raoul Wallenberg, për të bashkuar ekspertë të pavarur ndërkombëtar me qëllim elaborimi të rekomandimeve dhe zgjidhje alternative në përputhshmëri me standardet relvante ndërkombëtare.

Rezultati i iniciativës së lartëpërmendur janë Rekomandimet e Lund-it për Pjesëmarrjen Efektive të Pakicave Kombëtare në Jetën Publike-e quajtur sipas qytetit suedez ku ekspertët u tubuan dhe i kompletuan rekomandimet për herë të fundit. Në mesin e tyre kishte ekspertë dhe juristë - specialistë për të drejtën ndërkombëtare, shkenctarë politik - specialistë për sistemin kushtetues dhe zgjedhor dhe sociologë - specialistë për të drejtat e pakicave. Ekspertët që punonin nën udhëheqjen e profesorit Gudmundur Alfredsson që njëherit ishte edhe drejtor i Institutit Raoul Wallenberg ishin :

- Profesor Gudmundur Alfredsson (islandez), Drejtor i Institutit Raoul Wallenberg për të Drejtat e Njeriut dhe të Drejtën Humanitare, Universiteti Lund;
- Profesor Vernon Bogdanor (anglez), Profesor për qeverisje shtetërore, Universiteti Oxford;
- Profesor Vojin Dimitrijevic (jugosllav), Drejtor i Qendrës të Beogradit për të Drejtat e Njeriut;
- Dr. Asbjorn Eide (norvegjez), bashkëpunëtor i lartë në Institutin Norvegjez për të Drejtat e Njeriut;
- Profesor Yash Ghai (kenian), Sir YK Pao Profesor i të Drejtës Publike, Univesiteti Hong Kong;
- Profesor Hurst Hannum (amerikan), Profesor i së Drejtës Ndërkombëtare, Fakulteti Fletcher për Drejtësi dhe Diplomaci, Universiteti Tufts;
- z. Peter Harris (jugafrikan), Drejtor egzekutiv i lartë në Institutin Ndërkombëtar për Demokraci dhe Ndhimë gjatë zgjedhjeve;
- Dr. Hans-Joachim Heintze (gjerman), drejtor për Drejtën e Sigurimit të Paqës dhe për të Drejtën Humanitare Kombëtare, Ruhr-Universiteti Bochum;
- Profesor Ruth Lapidot (izraelit), Profesor i të Drejtës Ndërkombëtare dhe Kryetar i Komitetit Akademik i Institutit për Studime Evropiane, Universiteti Hebreik në Jerusalem;
- Profesor Rein Müllerson (estonian), ligjerues i të Drejtës Ndërkombëtare, Kolegji Mbretëror, Universiteti i Londrës;
- Dr. Sarlotta Pufflerova (slovaqe), drejtore e Fondacionit për Qytetarë dhe Pakica/Grupi për të Drejtat e Pakicave;
- Profesor Steven Ratner (amerikan), Profesor i të Drejtës Ndërkombëtare, Universiteti Texas;
- Dr. Andrew Reynolds (anglez), profesor-asistent për Qeverisje Shtetërore, Universiteti Notre Dame;
- Mr. Miquel Styruhel (spanjoll), Drejtor i Institutit për Gjuhë Katalane dhe Sociologjike;
- Prof. Marku Suksi (finlandez), Profesor i të Drejtës publike në Universitetin Akademik Abo;
- Prof. Danilo Türk (slloven), Profesor i të Drejtës Ndërkombëtare, Universiteti Lublanë;
- Dr. Fernand de Varennes (kanadez), ligjerues i lartë i Drejtësisë dhe Drejtor i Qendrës Aziatiko-Pacifike për Parandalim të Konfliktit Etnik, Universiteti Murdoch;
- Prof. Roman Wieruszewski (polak), Drejtor i Qendrës në Poznan për të Drejtat e Njeriut, Akademia Poljake e Shkencave.

Në pjesën ku standardet egzistuese të të drejtave të pakicave janë pjesë e të drejtave njerzore, fillimi i konsultimeve mes ekspertëve ishte të vërtetohet shkalla e përputhshmërisë e shteteve me të gjitha obligimet tjera rreth të drejtave të njeriut duke përfshirë sidomos jo-diskriminimin. Gjithashtu u vërtetua se qëllimi përfundimtar i të gjitha të drejtave të njeriut është zhvillimi i plotë dhe i lirë i çdo personaliteti në kushte të barazisë. Rrjedhimisht, u vërtetua se shoqëria qytetare duhet të jetë e hapur dhe fluide dhe prandaj t'i integrojë të gjithë njerëzit duke i përfshirë edhe ata që u takojnë pakicave kombëtare. Për më tepër në pjesët ku qëllimi i qeverisjes së mirë dhe demokratike është të shërbejë për nevojat dhe interesat e të gjithë popullatës, nënkuptohet se të gjitha qeveritë synojnë kah sigurimi i mundësive maksimale për kontributet e atyre që janë të goditur nga organet vendim-marëse.

Qëllimi i Rekomandimeve të Lund-it si dhe atyre të Hagës dhe Oslos paraprakisht, është të inkurajohet dhe mundësohet aprovimi i masave specifike nga shtetet për të zvogluar tensionet lidhur me pakicat kombëtare dhe kështu t'i shërbejë qëllimit kryesor të KLPK për parandalim të konflikteve. Rekomandimet e Lund-it për Pjesëmarrje Efektive të Pakicave Kombëtare në Jetën Publike tentojnë të sqarojnë në mënyrë të hapur përmbajtjen e të drejtave të pakicave dhe standardeve të tjera në situata ku inkuadrohet KLPK. Këto standarde janë miratuar në mënyrë specifike për të siguruar koherencën e aplikimit të tyre në shtetet e hapura dhe demokratike. Rekomandimet naden në katër pjesë të cilat i përmbledhin 24 rekomandimet në parime gjenerale, pjesëmarrja në sjelljen e vendimeve, vetëqeverisja lokale dhe forma të garancës për pjesëmarrje efektive në jetën publike. Ndarja themelore dhe konceptuale në kuadër të rekomandimeve të Lund-it ndjek dy kahje: pjesëmarrja në qeverisjen e shtetit si një tërësi, dhe vetëqeverisja lokale në çështje lokale ose të brëndshme. Shumëllojshmëri e gjerë e aranzhmaneve është e mundshme dhe e njohur. Në disa rekomandime sugjerohen edhe alternativa. Të gjitha rekomandimet duhet të interpretohen në përputhshmëri me Parimet e Përgjithshme në Pjesën e I. Sqarim më i detajshëm për çdo rekomandim është dhënë në shtojcën me titullin "Sqarime" të bëra në pajtim me standarde relevante ndërkombëtare.

I. PARIMET E PERGJITHSHME

- 1) *Pjesmarrja efektive e pakicave kombëtare në jetën publike është një komponentë kyçe e çdo shoqërie paqëndashëse dhe demokratike. Përvoja në Evropë dhe më gjërë tregon se, për t'i avansuar pjesmarrjet e këtilla, qeveritë shpeshherë duhet të miratojnë norma të posaçme për pakicat kombëtare. Rekomandimet e këtilla kanë për qëllim përfshirjen e pakicave në shoqëri, mundësimi i ruajtjes së identitetit dhe veçantive të tyre nëpërmes avansimit të qeverisjes së mirë shtetërore si dhe integritetin e shtetit.*
- 2) *Këto rekomandime bazohen në parimet themelore dhe rregullat e të drejtës ndërkombëtare, si ç'është respektimi i dinjitetit njerëzor, të drejta të barabarta dhe jo-diskriminimi, pasi që këto pengojnë të drejtat e pakicave kombëtare për pjesmarrje në jetën publike si dhe të gëzojnë të drejtat e tjera politike. Shtetet kanë obligim t'i respektojnë të drejtat ndërkombëtare humanitare, si dhe rregullat ligjore të cilat mundësojnë zhvillim të tërësishëm të një shoqërie qytetare në kushte tolerance, paqe dhe prosperiteti.*
- 3) *Kur krijohen institucione specifike, ato kanë për qëllim të sigurojnë pjesëmarrjen efektive të pakicave në jetën publike e cila mund të përfshiej ushtrimin e autoritetit ose përgjegjësisë nga këto institucione, ato duhet t'i respektojnë të drejtat njerëzore të pakicave në fjalë.*
- 4) *Individët e identifikojnë vetëvehten në mënyra të ndryshme krahas identifikimit të tyre si anëtarë të një pakice kombëtare. Vendimi i personit të jetë anëtar i pakicës, i shumicës ose i asnjërës është ë drejtë e tij dhe nuk duhet t'i imponohet. Për më tepër askush nuk duhet të përjetojë ndonjë mospërparësi si rezultat i këtij vendimi.*
- 5) *Gjatë krijimit të institucioneve dhe procedurave në përputhje me këto Rekomandime janë të rëndësishme si përmbajtja ashtu edhe procesi. Organet qeveritare dhe pakicat duhet t'i përmbahen procesit inkluziv, transparent dhe adekuat për të mirëmbajtur klimë besimi. Shteti duhet t'i inkurajojë mjetet për informim publik që t'a forcojnë mirëkuptimin ndërkulturor dhe t'i theksojnë problemet e pakicave.*

II. PJESËMARRJA NË SJELLJEN E VENDIMEVE

A. Aranzhmane në nivel të Qeverisë Qëndrore

- 6) Shtetet duhet të sigurojnë mundësi për pozitë efektive të pakicave në qeverisjen qëndrore bile edhe nëpërmjet aranzhmane të posaçme nëse ka nevojë. Varësisht nga rrethanat, këto mund të përfshijnë:
 - * përfaqësim të vecantë të pakicave si p.sh. nëpërmjet sigurimit të numrit të caktuar të vendeve në njëren ose dy dhomat e parlamentit ose në komisionet parlamentare; si dhe formave të pjesëmarrjes të garantuar në procesin legjislativ;
 - * marrëveshje formale ose joformale për emërimin e anëtarëve të pakicave në funksione qeveritare, pozita në gjyqjin suprem ose kushtetues ose gjyqje të nivelit më të ulët, dhe pozita në komisione këshilldhënëse, ose në organe tjera të niveleve më të larta;
 - * mekanizma për të siguruar se interesat e pakicave janë përqëndruar në ministritë relevante si p.sh. personeli që do të merret me çështjet e pakicave ose marrjen e udhëzimeve dhe vendimeve adekuate; dhe
 - * masa të vecanta për pjesëmarrjen e pakicave në shërbimet publike si dhe sigurimin e shërbimeve publike në gjuhën e pakicës kombëtare.

B. Zgjedhjet

- 7) Përvoja në Evropë dhe më gjërë tregon rëndësinë e procesit zgjedhor për sigurimin e pjesëmarrjes së pakicave në sferën politike. Shtetet i garantojnë të drejtat e personave që u takojnë pakicave kombëtare të pjesmarrje në jetën publike duke përfshirë të drejtën për votim dhe kandidimin për funksion publik pa asnjë diskriminim.

- 8) Rregullimi i formimit dhe aktivitetit të partive politike duhet të përputhet me parimet e ligjit ndërkombëtar për lirinë e shoqerimit. Ky parim përfshin lirinë e formimit të partive politike e të bazuara në identitetet e bashkësive si dhe të atyre që nuk identifikohen vetëm me interesat e ndonjë komuniteti.
- 9) Sistemi zgjedhor duhet të mundësojë përfaqësimin dhe ndikimin e pakicave.

- * Në teritoret ku janë të koncentruara pakicat njësitë zgjedhore njëanëtarëshe mund të sigurojnë përfaqësim të mjaftueshem të pakicës.
 - * Sistemi proporcional ku pjesëmarrja e partisë politike në votën kombëtare reflektohet në pjesëmarrjen e saj në trupat legjislativ, mund të ndihmojë në përfaqësimin e pakicave.
 - * Disa forma të votimit të preferuar, ku votuesit i rangojnë kandidatët sipas zgjedhjes së tyre, mund t'a ndihmojnë përfaqësimin e pakicës dhe t'a promovojë bashkëpunimin ndërkomunal.
 - * Pragu më i vogël për përfaqësim në trupat ligdhënës mund të zmadhojë përfaqësimin e pakicave në qeverisje me shtetin.
- 10) Kufijtë gjeografik të njësive zgjedhore duhet të mundësojnë përfaqësim të barabartë të pakicave kombëtare.

C. Aranzhmanet në Nivel Regjional dhe Lokal

- 11) Shtetet duhet të miratojnë masa për promovimin e pjesëmarrjes së pakicave kombëtare në nivel regjional dhe lokal, konform masave të lartpërmendura në lidhje me raportet në nivel të qeverisjes qendrore (pika 6 deri 10). Strukturat dhe procesi i sjelljes së vendimeve në organet regjionale dhe lokale duhet të bëhen transparente dhe të afërta, për t'a inkurajuar pjesëmarrjen e pakicave.

D. Trupat Këshillues dhe Konsultativ

- 12) Shtetet duhet të themelojnë trupa këshillues ose konsultativ në kuadër të kornizave adekuate institucionale që do të shërbenin si kanale për dialog me autoritetet qeveritare dhe pakicave. Këta trupa mund të përfshijnë edhe komisione me qëllime të caktuara për të çështje të ndryshme siç janë banimi, raportet e pronësisë, shkollimi, gjuha dhe kultura. Përbërja e këtyre trupave duhet të reflektojë qëllimin dhe kontributin e tyre për komunikim më efektiv dhe avansim të interesave të pakicës.
- 13) Këta trupa duhet të shqyrtojnë çështje së bashku me marrësit e vendimeve, të pregadisin rekomandime, të formulojnë propozime ligjore dhe të ngjajshme, të mbikqyrin zhvillimet dhe të sigurojnë qëndrime në vendimet e propozuara nga qeveria të cilat në menyrë direkte ose indirekte kanë të bëjnë me pakicat. Autoritetet qeveritare duhet që rregullisht të konsultojnë këta trupa lidhur me aktet juridike të pakicave dhe masat administrative që të kënaqin kërkesat e pakicave dhe të ndërtojnë besim. Funkcionimi efektiv i këtyre trupave kërkon edhe resurse adekuate.

III. VETËQEVERISJA LOKALE

- 14) Pjesëmarrja efektive e pakicave në jetën publike mund të kërkojë aplikimin e aranzhmaneve joteritoriale ose territoriale të vetëqeverisjes ose kombinim të të dyjave. Shtetet duhet të sigurojnë resurse të duhura për këto aranzhmane.
- 15) Per suksesin e këtyre aranzhmaneve është qenësore që autoritetet qeveritare dhe pakicat të njohin nevojën për vendime qendrore dhe uniforme në disa fusha të qeverisjes së bashku me përparsitë dhe dallimet në vendimet e tejsra.

- * Funkcionet e ushtruara nga autoritetet qendrore përfshijnë mbrojtjen, punët e jashtme, imigrimin dhe doganën, politikën makroekonomike dhe çështjet monetare.
 - * Funkcionet tjera, si ato të poshtëpërmendurat, mund të udhëhiqen nga pakicat ose administratat lokale ose së bashku me organet qendrore.
 - * Funkcionet mund të realizohen në mënyrë asimetrike që t'iu përgjigjen situatave të pakicave të ndryshme në të njëjtin shtet.
- 16) Institucionet e vetëqeverisjes, qofshin ato joteritoriale ose teritoriale, duhet të bazohen në parime demokratike për të siguruar se ato me të vërtetë i reflektojnë qëndrimet e popullatës në fjalë.

A. Aranzhmanet Joteritoriale

- 17) Këto forma të qeverisjes janë të dobishme për mbarvajtjen dhe zhvillimin e identitetit dhe kulturës së pakicave kombëtare.
- 18) Çështjet më të ndijshme në këto aranzhmane përfshijnë shkollimin, kulturën, përdorimin e gjuhëve të pakicës, fenë dhe çështje tjera qenësore për identitetin dhe mënyrën e jetës të pakicave kombëtare.
- * Personat dhe grupet kanë të drejtë t'i përdorin emrat në gjuhën e pakicave dhe të kenë njohje zyrtare të tyre.
 - * Duke marrë parasysh përgjegjësinë e organeve qeveritare për të caktuar standardet e shkollimit, institucionet e pakicave mund t'a caktojnë programin e mësimi të gjuhës dhe kulturës së pakicës ose të të dyjave.
 - * Pakicat i përcaktojnë dhe i gëzojnë të drejtat e siomboleve të tyre dhe format tjera të shprehjeve kulturore.

B. Aranzhmanet Teritoriale

- 19) Të gjitha shtetet demokratike kanë aranzhmane për qeverisje në nivele të ndryshme teritoriale. Përvoja në Europë dhe më gjërë thekson vlerën e zhvendosjes të funksioneve të caktuara legjislative dhe egzekutive nga niveli qendror në atë regjional, krahas decentralizimit të plotë të administrimit qendror shtetëror prej shërbimeve qendrore në ato regjionale ose lokale. Varësisht nga parimi plotësues, shtetet në mënyrë të favorshme duhet t'i konsiderojë këto ndarje teritoriale të qeverisjes duke përfshirë këtu funksione të veçanta të vetëqeverisjes, sidomos aty ku ato do t'i përmirsonin mundësitë e pakicave për të qeverisur rreth çështjeve të lidhura me to.
- 20) Administrimi i duhur lokal, regjional ose autonom që korespondon me rrethanat e caktuara historike dhe teritoriale të pakicave kombëtare, mund të ndërmerren shumë funksione për t'iu përgjigjur në mënyrë më efektive kërkesave të këtyre pakicave.
- * Qeverisjet ku ky administrim ka arritur suksese me funksionet e tij përfshijnë shkollimin, kulturën, përdorimin e gjuhës së pakicave, ambientin jetësor, planifikimin lokal, resurset natyrore, zhvillimin ekonomik, funksionet e policisë lokale, banimin, shëndetsinë dhe shërbime tjera shoqërore.
 - * Funkcionet e ndara nga qeverisja qendrore dhe ajo regjionale përfshijnë tatimin, administratën juridike, turizmin dhe transportin.
- 21) Autoritetet lokale, regjionale, dhe autonome janë të detyruara t'i respektojnë dhe t'i sigurojnë të drejtat e njeriut duke përfshirë të drejtat e çdo pakice në kuadër të jurisdikcionit të tyre.

IV. GARANCITË

A. Garancitë Kushtetuese dhe Ligjore

22) Aranzhmanet për vetëqeverisje duhet të themelohen me ligj dhe ato nuk duhet të ndërrohen në të njëjtën mënyrë si ligjet e zakonshme. Aranzhmanet që promovojnë pjesëmarrjen e pakicave në sjelljen e vendimeve mund të përcaktohen me ligj ose me forma tjera adekuate.

* Aranzhmanet e përvetsuara si materje kushtetuese miratohen me një shumicë më të madhe votash në organet ligjdhënëse ose gjatë votimit nga ana e popullatës, kur duhet të mirret pëlqimi për sjelljen ose ndryshimin e tyre.

* Ndryshimet e aranzhmaneve për vetëqeverisje të themeluara nga institucionet ligjore shpesh kërkojnë aprovim nga mazhoranca e kualifikuar e trupave ligjdhënës, trupave autonom ose trupave që përfaqësojnë pakicat kombëtare ose e të dyjave.

* Shqyrtimi periodik i aranzhmaneve për vetëqeverisje dhe pjesëmarrja e pakicave në sjelljen e vendimeve mund të sigurojnë mundësi të dobishme për të përcaktuar se vallë këto aranzhmane duhet ndryshuar sipas përvojës paraprake dhe rrethanave të ndryshuara.

23) Gjithashtu mund të merret parasysh mundësia e aranzhmaneve të përkohshme ose sukcesive që lejojnë kontrollimin dhe zhvillimin e formave të reja për pjesëmarrje. Këto aranzhmane mund të themelohen nëpërmjet trupave ligjdhënëse ose mjeteve joformale me periudhë të caktuar kohore të cilat mund të zgjerohen, ndryshojnë ose të zgjasin varësisht nga suksesi i arritur.

B. Masat Ligjore

24) Pjesëmarrja efektive e pakicave kombëtare në jetën publike kërkon kanale të definuara të konsultimit për parandalim të konflikteve dhe zgjidhje të mosmarrvëshjeve, si dhe mundësi për *ad hoc* mekanizma ose mekanizma alternativ sipas nevojës. Këto metoda përfshiejnë:

* zgjidhje gjyqësore të konflikteve, siç janë shqyrtimi gjyqësor i ligjeve ose masave administrative. Për këtë shteti duhet të posedojë gjyqësi të pavarur, adekuate dhe neutrale, vendimet e së cilës do të respektohen; dhe

* mekanizma shtues për zgjidhje të mosmarrvëshjeve, si p.sh. negociatat, vërtetimi i fakteve, ndërmjetsimi, arbitrimi, ombudsmani për pakica kombëtare dhe komisione speciale të cilat mund të shërbejnë si pika kryesore dhe mekanizma për zgjidhje të ankesave rreth qeverisjes shtetërore.

MATERIAL PËR LEXIM TË MËTUTJESHËM:

Myntti, Kristian (2001)

“Një koment për Rekomandimet e Lund-it mbi pjesëmarrjen efektive të minoriteteve kombëtare në jeten publike” (titulli i origjinalit *“A Commentary to the Lund Recommendations on the Effective Participation of National Minorities in Public life”*)

Instituti për të drejtat e njeriut, Universiteti “Abo Akademia”, Turku/Abo

OSBE – Zyra për institucione demokratike dhe të drejtat e njeriut (2001),

“Udhëzime për të ndihmuar pjesëmarrjen e minoriteteve kombëtare në procesin e zgjedhjeve” (titulli i origjinalit *“Guidelines to Assist National Minority Participation in the Electoral Process”*,

Varshavë (www.osce.org/odihr/documents/guidelines/gl_nmpa_eng.pdf)

Ghai, Yash (2001)

“Pjesëmarrja publike dhe minoritetet” (titulli i origjinalit *“Public Participation and Minorities”*),

Grupi për të drejtat e minoriteteve, Londër (www.minorityrights.org)

Dimitrijević, Nenad (edicioni i vitit 2000)

“Menaxhimi i komuniteteve multietnike lokale në vendet e ish Jugosllavisë” (titulli i origjinalit *“Managing Multiethnic Local Communities in the Countries of the Former Yugoslavia”*, Iniciativa për reforma në qeverisjen lokale dhe në shërbimet publike – Instituti për shoqëri të hapur, Budapest (<http://lgi.osi.hu/publications/default.asp?id=26>))

Biro, Anna-Maria dhe Kovacs, Petra (edicionet e vitit 2001)

“Diversiteti në veprë: Menaxhmenti lokal publik i komuniteteve multietnike në Evropën qendrore dhe lindore” (titulli i origjinalit *“Diversity in Action: Local Public Management of Multi-ethnic Communities In Central and Eastern Europe”*) Iniciativa për reforma në qeverisjen lokale dhe në shërbimet publike –

Instituti për shoqëri të hapur, Budapest (<http://lgi.osi.hu/publications/default.asp?id=18>)

“Instruksione për qeverinë lokale”

(titulli i origjinalit *“Local Government Brief”*) Zhurnali për çështje tremujore, Iniciativa për reforma në qeverisjen lokale dhe në shërbimet publike – Instituti për shoqëri të hapur, Budapest (<http://lgi.osi.hu/publications/default.asp?idx=inseries&id=4>)

Komunat në Kosovë



Mcode	Shqip	Sërbisht	Turqisht
01	Deçan	Dečani	Deçan
02	Gjakovë	Đakovica	Yakova
03	Gillogovc	Glogovac	Glogovats
04	Gjilan	Gnjilane	Gilan
05	Dragash	Dragaš	Dragash
06	Istog	Istok	Istok
07	Kaçanik	Kačanik	Kaçanik
08	Klinë	Klinë	Klina
09	Fushë Kosovë	Kosovo Polje	Kosova Ovasi
10	Kamenicë	Kamenica	Kamenitsa
11	Mitrovicë	Mitrovica	Mitrovitsa
12	Leposaviq	Leposavić	Leposaviç
13	Lipjan	Lipljan	Lipjan
14	Novobërdë	Novo Brdo	Nobrda
15	Obiliq	Obilić	Obiliç
16	Rahovec	Orahovac	Orahovça
17	Pejë	Peć	Ipek
18	Podujevë	Podujevo	Podujeva
19	Prishtinë	Priština	Pristine
20	Prizren	Prizren	Prizren
21	Skenderaj	Srbica	Srbitsa
22	Shtime	Štimlje	Stimle
23	Shtërpçë	Štrpce	Strptse
24	Suharekë	Suva Reka	Suva Reka
25	Ferizaj	Uroševac	Ferizovik
26	Viti	Vitina	Vitina
27	Vushtri	Vučitrn	Vuçitirn
28	Zubin Potok	Zubin Potok	Zubin Potok
29	Zveçan	Zvečan	Zveçan
30	Malishevë	Mališevo	Maliseva